



Shqipëria **110 VJET SHTET**



Revista Drita Islame në versionin online...

www.dritaislame.al



TEOLOGJI

BOTA JONË

REFLEKSIONE

TRASHËGIMI KULTURORE

FAMILJA

PERSONALITETE



www.dritaislame.al

"Drita islame"
Botim i Komunitetit Mysliman
të Shqipërisë

DREJTOR
Dorian Demetja

KRYEREDAKTOR
Mehmet Disha

REDAKTOR
Andrin Rasha

DIZAJNI DHE FAQOSJA
Ejup Lila

KONTAKT:
Tel/fax 04 223 04 092
E-mail: info@dritaislame.al

Viti XXXI i botimit
Nr. 11 (474)
Nëntor, 2022


ISSN 2226-7115



Artikujt
që vijnë në redaksi
dhe botohen,
nuk paraqesin domosdoshmërisht
edhe pikëpamjet e revistës.
Materialet e sjella në redaksi,
pavarësisht nëse botohen apo jo,
nuk i kthehen autorit.

PËRMBAJTJA

- 4 Shqipëria, 110 vjet shtet / Mehmet Disha
- 6 Roli i prijësve myslimanë në formimin e shtetit të parë shqiptar / Dr. Mojs Kamberi
- 10 Lajme / Aktivitete



- 14 Themeli i Islamit është kuptim dhe besim / H. Bujar Spahiu
- 16 Modeli Islam për emancipimin e gruas / Prof. Doc. Muhamed Amareh
- 20 Veçoritë e sahabëve / Shkëputur nga libri "Jeta e Sahabëve 1", botim i KMSH
- 22 32 vjetori i lirisë së besimit / Redaksia
- 24 A e kuptojnë ç'po ndodh me ta? / Muhamed Asad
- 26 Flakë kashte / Nuredin Nazarko



- 28 Feja dhe kombësia / Retrospektivë
- 32 Hafiz Qazim Zenel Rakiqi (1921-1991) / Personalitet
- 34 Të ndërtosh familje / Aisa Kokiçi
- 36 Kanceri, një anarki qelizore / Ali Fethi Toprak
- 38 I gjalli dhe i vdekuri / Elez Lagreta



Shqipëria 110 VJET SHTET

Pavarësia e vendit tonë ishte fryt i ndërgjegjes kombëtare e shoqëruar me përpjekje, djersë e gjak prej bijve që lindi e rriti ky truall. Vatra e atdheut mblodhi ëndrrat e përbashkëta dhe zemrat e njerëzve që kërkonin lirinë.

Njëqind e dhjetë vjet më parë, populli ynë fitoi të drejtën për të jetuar i lirë e i pavarur në vendin e tij. Që nga ajo kohë, shumë gjëra kanë ndryshuar dhe ka patur periudha të vështira që popullit tonë i është dashur të përballojë, e megjithatë, forca qëndron dhe shpresa për qetësi e zhvillim, mbetet pjesë e zemrës së gjithkujt.

Kujtojmë me nderim medresistët e hoxhallarët, që me përkushtim, përgjegjësi kombëtare e fetare islame dhe sakrificë, dhanë kontributin maksimal për ta bërë Shqipërinë të lirë, të pavarur dhe popullin shqiptar të bashkuar. Deri në arritjen e kësaj dite, populli ynë provoi pushtues të shumtë. Tashmë, mes gjithë atyre vështirësive, kemi një shtet tonin e gëzojmë të drejtën e mëvetësisë.

Është e qartë që personalitete të shquara të fesë Islame kanë dhënë një kontribut të veçantë për ekzistencën e popullit dhe të kombit shqiptar. Në përpjekjet dhe në luftën e gjatë për ruajtjen e identitetit kombëtar, ata kanë marrë pjesë në të gjitha ngjarjet më të rëndësishme. Mjafton të hedhim një sy me kujdes në të gjitha ngjarjet

me karakter historik dhe politik dhe do vëmë re se prania e prijësve myslimanë është kudo e pashmangshme. Që nga kryengritjet kundër Tanzimatit me sheh Mustafën e sheh Fezën e deri te përfaqësimi në organizma si Komiteti i Stambollit, me Hoxha Hasan Tahsinin e madh, duke vazhduar me Daut efendi Boriçin, në Lidhjen e Prizrenit, me Hafiz Ibrahim Shkupin, në Kongresin e Manastirit, me Myfti Vehbi Dibrën, Hafiz Ali Korçën dhe Ismail Efendi Ndroqin në Kongresin e Dibrës, me Myfti Vehbi Dibrën e Sheh Ahmet Pazarin në shpalljen e Pavarësisë më 1912 dhe ngritjen e flamurit, etj.

Pra, në gjithë rrjedhën e ngjarjeve që përcaktojnë fatin e Shqipërisë e të shqiptarëve, pa dyshim, gjen edhe ata, krerët e besimit mysliman, krah për krah, dorë për dorë e gojë për gojë me të gjithë klerikët e besimeve të tjera në Shqipëri.

Feja Islame është universale. Ajo, në shpirtin e besimtarëve, u jep jetë e gjallëri kombësive, mbi bazën e respektimit të barazisë midis tyre. Zoti në Kur'anin Famëlartë urdhëron:

“O ju njerëz! (është thirrje dhe urdhër për tërë njerëzimin) Vërtet Zoti ju krijoi juve nga një mashkull e një femër (jeni vëllezër e jetoni si të barabartë). Ju bëri popuj e fise që



të njiheni midis jush e, pa asnjë dyshim, tek Allahu, më i nderuari prej jush, është më i ruajturi (nga padrejtësitë).” (Kur’an, 49:13)

Që kur lind njeriu, lind për të jetuar i lirë. Ai nxirret nga errësira e bëhet i lirë e i aftë të zgjedhë vetë rrugën e jetës. Krijimi në kombësi të ndryshme e në gjuhë të ndryshme u jep të drejtën këtyre kombësive ta ndërtojnë jetën në vendet e tyre, të lirë e të pavarur. Pra, askush, as i madh e as më i fuqishëm, nuk ka të drejtë t’u heqë kombësive të tjera të drejtën për të jetuar të lirë e të pavarur. Kjo është e drejta islame për popujt. Zoti i krijoi të jetojnë të lirë.

Feja Islame, në mënyrë të përsosur, thekson detyrimet që sjellin pavarësinë. Ajo bën detyrë të domosdoshme pavarësinë. Gjithashtu bën detyrë edhe njohjen, ruajtjen dhe zhvillimin e vendlindjes.

“Të duash atdheun është detyrë e besimit Islam.” – thotë Profeti (a.s.) Ai që i përkushtohet atdheut dhe popullit të tij, deri në sakrificën finale, merr dy shpërblime: në vlerësimin Islam radhitet pas profetëve, emërohet “shehid” dhe është i shlyer nga tërë përgjegjësitë e tjera. Futet e përjetësohet në ndërgjegjen e popullit.

Epokë pas epoke, në njëfarë mënyre, vendi ynë akoma nuk arriti ta gjente lulëzimin siç duhej, në mënyrë që

të mund të kishim zhvillimin dhe përparimin e duhur krahas kombeve të tjera. Sot, 110 vjet që pas shpalljes së pavarësisë, ende kemi një sërë problematikash madhore me të cilat na duhet të përballemi: ikja e të rinjve, zbrazja e qyteteve e fshatrave, mangësia e mundësive, korrupsioni dhe vjedhja, janë bërë shkak që vendi ynë të stonojë përballë tejkalimit të së keqes.

Megjithatë, Zoti nuk e ndryshon gjendjen e një populli gjersa ai vetë të përpiqet të ndryshojë vetveten. Këtu është rëndësia madhore e fesë Islame në ditët e sotme, sepse feja mban shtyllat e moralit gjallë, forcon ndërgjegjen, ruan mirësinë e zemrave dhe pastërtinë e besimeve dhe ajo e forcon individin të punojë për nga e mira dhe të ruhet nga e keqja. Përderisa do të ketë njerëz që e duan kombin dhe i përmbahen fesë, do të ketë gjithmonë premisa se e nesërmja do të sjellë zhvillim dhe ndryshim. Kjo sigurisht, kërkon forcë, por këtu e provon veten një komb, te forca për ndryshim, gjë që nuk na ,ungon ne shqiptarëve.

Zoti e begatoftë këtë vend dhe e gjallëroftë me filiza të rinj që e duan fenë dhe i frikësohen Zotit me devotshmëri, e, i përkushtohen atdheut për të për mirësuar edhe jetët e të tjerëve!

Roli i prijësve myslimanë

NË FORMIMIN E SHKOLLËS SË PARË SHQIPTAR



Shekulli XIX shënoi një epokë të re për popullin shqiptar, atë të Rilindjes. Ai hyri në historinë moderne të vendeve të Ballkanit si shekulli i lëvizjeve dhe revolucioneve kombëtare, që çuan në çlirimin dhe formimin e shteteve të pavarura. Për një varg rrethanash të brendshme e të jashtme, Shqipëria ishte vendi i fundit në Ballkan që u shkëput nga Perandoria Osmane dhe që shpalli pavarësinë kombëtare. Gjatë Rilindjes Kombëtare lindi dhe u zhvillua ideologjia e re kombëtare, e cila, duke u ngritur mbi ndarjet krahinore e fetare, shprehte aspiratat jo më të krahinave të veçanta, por të gjithë Shqipërisë dhe shqiptarëve si komb.¹

Lëvizja Kombëtare Shqiptare për pavarësi dhe krijimi i shtetit shqiptar të pavarur, përbën një shembull mjaft domethënës të bashkëpunimit të singertë dhe pa asnjë paragjykim të intelektualëve dhe aktivistëve patriotë, të cilët, pavarësisht nga përkatësia fetare, dhanë një kontribut vendimtar për afirmimin politik e kulturor të kombit shqiptar. Të dhënat e përfuara nga burime të ndryshme historike vërtetojnë qartësisht ekzistencën e tolerancës dhe të bashkëjetesës paqësore midis shqiptarëve të besimeve të ndryshme.

Periodua e Rilindjes Kombëtare, ajo e pavarësisë dhe e luftërave të ndryshme në mbrojtje të trojeve shqiptare, dëshmuar se ekzistenca e besimit fetar, jo vetëm që nuk u bë pengesë për përballimin e situatave të vështira të atyre kohëve, por shërbeu si faktor i domosdoshëm për ruajtjen e pavarësisë dhe forcimin e shtetit, duke u vlerësuar se diversiteti fetar ka qenë dhe është një pasuri kombëtare, kjo falë prijësve të shquar fetarë. Shumë kuvende e kryengritje lokale, krahinore, ndërkrahinore dhe mbarëkombëtare u udhëhoqën dhe u drejtuan nga klerikë të shquar shqiptarë. Një realitet ky, i cili herë pas here vlerësohet edhe nga opinioni ndërkombëtar.

Kur udhëton nëpër analet e historisë shqiptare dhe

flet për lëvizjet dhe përpjekjet mbarëkombëtare, kupton se një rol të rëndësishëm kanë luajtur edhe rilindësit e mëdhenj shqiptarë, të cilët në shumë raste ishin drejtues fetarë, të cilët, në kushte dhe rrethana të ndryshme dhe shpeshherë mjaft të vështira, punuan për ngritjen e shtetit shqiptar, si dhe kontribuan për forcimin dhe konsolidimin e tij.

Është e qartë që kleri mysliman ka dhënë një kontribut të veçantë për ekzistencën e popullit dhe të kombit shqiptar. Në përpjekjet dhe në luftën e gjatë për ruajtjen e identitetit kombëtar, ai ka marrë pjesë në të gjitha ngjarjet më të rëndësishme. Mjafton të hedhim një sy me kujdes në të gjitha ngjarjet me karakter historik dhe politik dhe do vëmë re se prania e prijësve myslimanë është kudo e pashmangshme. Që nga kryengritjet kundër Tanzimatit me sheh Mustafën e sheh Fezën e deri te përfaqësimi në organizma si Komiteti i Stambollit, me Hoxha Hasan Tahsinin e madh, duke vazhduar me Daut efendi Boriçin, në Lidhjen e Prizrenit, me Hafiz Ibrahim Shkupin, në Kongresin e Manastirit, me Myfti Vehbi Dibrën, Hafiz Ali Korçën dhe Ismail Efendi Ndroqin në Kongresin e Dibrës, me Myfti Vehbi Dibrën e Sheh Ahmet Pazarin në shpalljen e Pavarësisë më 1912 dhe ngritjen e flamurit, etj.

Pra, në gjithë rrjedhën e ngjarjeve që përcaktojnë fatin e Shqipërisë e të shqiptarëve, pa dyshim, gjen edhe ata, krerët e besimit mysliman, krah për krah, dorë për dorë e gojë për gojë me të gjithë klerikët e besimeve të tjera në Shqipëri.

Ngjarje të rëndësishme mbarëkombëtare janë të lidhura me zhvillimin e tyre pranë institucioneve fetare gjatë Rilindjes Kombëtare Shqiptare si për shembull, Lidhja Shqiptare e Prizrenit u ndez në Medresenë e Xhamisë Bajrakli. Kryetari i saj pas Iljaz pashë Dibrës, u zgjodh kleriku Haxhi Ymer Prizreni, që ishte dhe kryeministri i parë shqiptar në Qeverinë e përkohshme të Lidhjes. Ishin klerikët ata që kontribuan së bashku me personalitete të shquara të vendit, për hapjen e mësonjëtorëve të para

1. ASHSH, *Histori e Popullit Shqiptar*, Vëll. II, Toena, Tiranë 2002, f. 27.



në gjuhën shqipe dhe për t'u mësuar fëmijëve shkrimin e këndimin e shqipes, si Hoxha Tahsini, Said Najdeni, Vehbi Dibra(Agolli), Hafiz Ali Korça, etj.

Gjatë viteve 1900-1912, ata i gjejmë të pranishëm në të gjitha ngjarjet më të rëndësishme të jetës politike, social-arsimore të vendit tonë, në kuvende dhe kongrese mbarëkombëtare si: Kuvendi i Pejës, i drejtuar nga kleriku Haxhi Zeka, kongreset arsimore të Manastirit e Ebasanit, në Kongresin e Dibrës të 23 korrikut 1909, të drejtuar nga Vehbi Dibra, në kuvendin e madh të Vlorës etj. Me mendimin dhe qëndrimin e mbajtur, klerikët shqiptarë luajtën rol të rëndësishëm në orientimin kombëtar të tërë jetës së vendit tonë. Në gjirin e kësaj lëvizje të gjerë politike, arsimore dhe ushtarake, ata bashkëvepruan dhe me figura të rëndësishme të lëvizjes sonë kombëtare, Ismail Qemalin, Isa Boletinin, Hasan Prishtinën, Luigj Gurakuqin, etj.

Në kuvendin e Pejës dhe të Dibrës të vitit 1899, Haxhi Zeka, Selim Rusi, Vehbi Dibra, Myfti Saliu, Myderiz Ismaili, Myderiz Abdullahu etj., luajtën një rol të rëndësishëm, duke dhënë një shembull se si duhej të zgjidhej çështja kombëtare. Klerikët jo vetëm ishin përfaqësues të krahinave të ndryshme shqiptare në këto kuvende, por dhe figura me shumë reputacion në delegatët e tjerë pjesëmarrës të këtij kuvendi. Fjala e tyre zinte vend sa herë që shprehej.

Përhapa e shkollave dhe e mësimit të gjuhës shqipe, si dhe zhvillimi i kulturës kombëtare, shtruan nevojën e caktimit të alfabetit të gjuhës shqipe. Për këtë u organizua Kongresi i Manastirit më 14 nëntor 1908. Delegatët e kongresit ishin shkrimtarët dhe publicistët më të njohur, lëvrues të gjuhës shqipe, laikë e klerikë si: Vehbi Dibra, Haziz Ibrahim efendi etj., shtruan domosdoshmërinë e caktimit të një alfabeti të vetëm të gjuhës shqipe.² Në këtë kongres klerikët mbështetën idenë për përdorimin e një alfabeti të ri të gjuhës shqipe me germa latine dhe për mësimin e shqipes në shkollat e Shqipërisë.³

Në Kongresin e Dibrës, Vehbi efendi Dibra, Hafiz Ali Korça, Haxhi Hafiz Ibrahim efendi, Hafiz Sherif Lëngu, etj., do të krijonin klube shqiptare e do të viheshin në krye të luftës kundër xhonturqve, që përpiqeshin të pengonin zhvillimin e kombit shqiptar, bashkimin e tij. Në Kongresin e Dibrës, Vehbi Dibra, për aktivitetin e tij fetar dhe politik, do të zgjidhej kryetar i Kongresit. Ky kongres i kalonte caqet kombëtare, gjë që tregohet nga pjesëmarrja e delegatëve laikë e klerikë jo vetëm nga vilajetet e Selanikut, Manastirit, Janinës, Kosovës dhe Shkodrës, por dhe e përfaqësuesve serbë, grekë, bullgarë e vllleh. Ky ishte i pari kongres ku më tepër se 300 delegatë toskë, gegë, myslimanë, ortodoksë, katolikë, priftërinj, hoxhallarë e shehelerë u konvertuan në një pikë, shkëputjen e Shqipërisë nga Turqia dhe arritjen e pavarësisë kombëtare.

2. ASHSH, *Histori e Popullit Shqiptar*, Vëll. II, Toena, Tiranë 2002, f. 392.

3. Prof. dr. Qazim Xhelili, Monografi, "Vehbi Dibra", Tiranë: Albin 1998, f. 27.

Atdhetarët Hafiz Ali Korça, Abdyl Ypi, Kenan Manastirli, Vehbi Agolli, Haxhi Ali Elbasani, etj., e bënë Kongresin e Dibrës arenë të luftës dhe shpalosjes së mendimit e kërkesave të mirëfillta të shqiptarëve, kërkesa që ishin nga më të avancuarat të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Si rezultat i kësaj lufte, kongresi punimet e tij i nisi dhe i përfundoi si një kongres shqiptar, si një kongres që trajtoi dhe shumë probleme të rëndësishme kombëtare që dilnin dhe jashtë kompetencave të rendit të ditës. Në të u ngritën probleme me kërkesa të mirëfillta shqiptare ku u shfaqën hapur:

- kërkesat me karakter të theksuar politik kombëtar, që çonin drejt realizimit të autonomisë së Shqipërisë,
- kërkesat për hapjen e shkollave shqipe të mbrojtura nga shteti,
- futjen e gjuhës shqipe në shkollat shtetërore,
- çështjen e alfabetit, etj.⁴

Punimet e Kongresit, lufta e ashpër politike që u zhvillua aty, provuan plotësisht se kërkesat e delegatëve patriotë ishin një përpjekje e hapur për realizimin e autonomisë së Shqipërisë. Kërkesa të tilla si ajo që nëpunësit e administratës vendase të dinin gjuhën dhe zakonet e vendit, futja e gjuhës shqipe në shkollat shtetërore, hapja e shkollave në gjuhën shqipe, kryerja e shërbimit ushtarak në vend, përdorimi dy gjuhësh në dokumentat përfundimtare të tij, janë arritjet më të mëdha të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, suksese që nuk ishin arritur në kongreset e tjera kombëtare.⁵

Në Kongresin e Elbasanit të 2 shtatorit 1909, prijësit myslimanë Hafiz Ibrahim Dalliu, Josi Haxhi Mima, Emin Haxhi Ademi dhe Hoxhë Muglica, bënë gjithçka për të hapur Normalen e Elbasanit, përkrah Luigj Gurakuqit, Hamdi Ohrit, Dervish bej Biçakut, Mit'hat Frashërit dhe të tjerëve.

Elita fetare e vendit ka meritat më të para nga të gjitha elitat e tjera. Në rast se vështrojmë kombet dhe historitë e tjera do të gjeni kombe të cilat kanë tradita mijëra vjeçare shkrimi, alfabetesh, bibliotekash, librash dhe qytetërimi. Por, kombi ynë ka një specifikë që nuk e ka asnjë komb tjetër, që është diamant i qytetërimit të kombeve, kjo është bashkëjetesa fetare. S'ka dhe s'mund të ketë asnjë tregues më epror për qytetarinë e një kombi sesa harmonia fetare.

Shqipëria përgjatë historisë së saj ka qenë një shembull se si njerëzit e fesë kanë ditur të zgjidhin saktë marrëdhëniet e besimit me kombin. Një mori dijetarësh shqiptarë të profilit fetar mysliman, katolik apo ortodoks kanë dhënë kontribut të çmuar në të gjitha fazat zhvillimore dhe format organizative të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Prijësit myslimanë, duke ruajtur harmoninë fetare, janë përpjekur në të gjitha mënyrat vetëm për një shoqëri me parime patriotike, për një shoqëri bashkëkohore, për forcimin e ndërgjegjes kombëtare, dashurisë për gjuhën

4. Gazmend Shpuza, "Kongresi kombëtar i Dibrës 1909", Dibër 2005, f. 32.

5. Manastirli Kenan, "Kongresi i Dibrës", Stamboll, 1912, f. 7.

dhe traditat shqiptare, dashurisë për atdheun e dashurisë për njëri-tjetrin. Më në veçanti kjo vepër bën ekzaminimin e përpjekjeve madhore të dijetarëve myslimanë, që nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit e deri në pavarësinë e Shqipërisë, jo vetëm për çlirim kombëtar, jo vetëm për arsimin e shkollat shqipe, por krijimin e shtetit shqiptar. Me firmën jo vetëm të patriotëve shqiptarë, por dhe të klerikëve myslimanë, si: Hafiz Ismet Dibra, Vehbi Dibra, Hafiz Sherif Lëngu, etj., Shqipëria të shpallej e pavarur.⁶

Pavarësia e Shqipërisë ishte aspiratë dhe punë atdhetare e një kombi të tërë nga gjiri i të cilit lindën shumë heronj. Midis tyre historiografia jonë duhet të nënvizojë fort emrat e klerikëve myslimanë, njerëz me shumë reputacion në mbarë Shqipërinë, të aftë, largpamës, me nuanjat e drejtpeshim politik.⁷

Kulmin e ngritjes së tyre jo vetëm si klerikë, por dhe si luftëtarë të çështjes kombëtare, ata do ta arrijnë me pjesëmarrjen në Kuvendin e Vlorës dhe zgjedhjen e tyre në organet më të larta të Qeverisë së Përkohshme.

Në situatën e krijuar, kur forcat ballkanike po pushtonin Shqipërinë dhe trevat shqiptare rrezikoheshin nga një copëtim i ri, rrethet atdhetare shqiptare brenda dhe jashtë atdheut arritën në përfundimin se e vetmja rrugë për shpëtimin e Shqipërisë ishte shpallja e Pavarësisë. Për këtë qëllim do të organizonin një kuvend mbarëkombëtar, ku do të merrnin pjesë delegatë të zgjedhur nga të gjitha krahinat shqiptare.

Telegrame të shumta të dërguara nga Vlora për Prefekturën e Elbasanit tregonin interesin e veçantë që kishin organizatorët e kuvendit për arritjen në Kuvendin e Madh të përfaqësuesve të klerikëve myslimanë, si: Vehbi Agolli (Dibra) dhe Hafiz Sherif Lëngu,⁸ personalitete me kontribut fetar e politik të gjithanshëm për çështjen kombëtare, mandate që ua ngarkonte mbarë popullsia e Dibrës dhe e krahinave përreth për të dërguar fjalën e tyre në Kuvendin Kombëtar në Vlorë.⁹

Për të plotësuar këtë detyrë të vështirë, mbledhjen e Kuvendit Kombëtar, më 21 nëntor 1912, Ismail Qemali arriti në Durrës. Plaku i urtë Ismail Qemali, Luigj Gurakuqi e atdhetarë të tjerë të shoqëruar nga Nikoll Kaçorri u nisën për në Vlorë.

Më 21 nëntor 1912, Isa Boletini, Ajdin bej Draga, Mehmet pashë Dërralla dhe delegatët e zgjedhur të Dibrës, Vehbi Agolli dhe Hafiz Sherif Lëngu, u nisën nga Dibra për në Elbasan¹⁰, ku i prisnin delegatët e kësaj treve për të shkuar së bashku drejt Vlorës.¹¹

Ndërsa delegatë nga të gjitha krahinat e tjera shqiptare grupoheshin dhe së bashku niseshin për në Vlorë, qyteteve shqiptare që rrezikoheshin nga pushtimi i

shteteve fqinje, iu kërkua që ta ngrinin sa më shpejt flamurin kombëtar, me qëllim që pushtuesi i ri t'i gjente të pavarura. Midis 37 delegatëve¹² dalloheshin klerikët Vehbi Agolli, Hafiz Sherif Lëngu dhe Dom Nikoll Kaçorri.

Përballë kërcënimit të ri të pushtimit nga ushtritë ballkanike dhe situatës së re të krijuar për trevat shqiptare, Ismail Qemali dhe atdhetarë të tjerë të mbledhur në Vlorë, hapën më 28 nëntor 1912, ora 14.00, punimet e Kuvendit Kombëtar për shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë, pa prituri ende të gjithë delegatët e krahinave shqiptare për shkak të vështirësive të mëdha që ekzistonin. Mendimi i klerikëve për Pavarësinë e Shqipërisë u mbështet nga të gjithë delegatët me në krye Ismail Qemalin, të cilët e shpallën Shqipërinë shtet të pavarur: "Shqipëria më sot të bëhet më vehte, e lirë e mosvarme".¹³

Pas shpalljes së pavarësisë, përpara kuvendit kombëtar shtroheshin detyra të reja historike: të ngrihej shteti i pavarur shqiptar me administratën dhe forcat e tij të armatosura, të sigurohej njohja ndërkombëtare e pavarësisë dhe e kufijve politikë shtetërorë, që të përfshihej në gjitha trojet etnike shqiptare, të shtrihej pushteti shtetëror në këto troje dhe të organizohej mëkëmbja dhe zhvillimi ekonomik i vendit.

Ismail Qemali i paraqiti Kuvendit dhe ia besoi atij zgjedhjen e anëtarëve të qeverisë. Rrjedhimisht anëtarët e saj duhet të ishin të njohur brenda dhe jashtë vendit. Më 4 dhjetor 1912, u zgjodh Qeveria e Përkohshme¹⁴. Në përbërjen e këtij kabineti qeveritar spikasnin krahas figurave të tjera atdhetare Myfit bej Libohova, Abdi bej Toptani, Mehmet pashë Deralla, Petro Poga, Luigj Gurakuqi, Mithat Frashëri, Pandeli Cale, Les Nosi dhe figurat e dy klerikëve Dom Nikoll Kaçori dhe Vehbi Agolli.

Me propozim të Ismail Qemalit, në Kuvend u zgjodhën dhe organet më të larta të përfaqësimit të qeverisë shqiptare. Në mbledhjen e dytë, që u hap më 30 nëntor 1912, me propozim të Luigj Gurakuqit, Vehbi Agolli u propozua të zgjidhej kryetari i Pleqësisë shqiptare (senatit). Më 4 dhjetor 1912, Kuvendi i Vlorës zgjodhi jo vetëm Qeverinë e Përkohshme, por dhe Pleqësinë prej 18 anëtarësh. Kryetar i pleqësisë u zgjodh Vehbi Dibra.¹⁵ Në Kuvendin e Vlorës, Vehbi Agolli bëri dhe betimin e flamurit dhe dha Fet'fanë për shpalljen e pavarësisë. Kjo që zgjedhja e dytë e një atdhetari klerikal në postet më të larta të qeverisjes pas zgjedhjes së Dom Nikoll Kaçorrit si nënkryetar i Qeverisë së Përkohshme të Vlorës. Ndërkohë që Ismail Qemali merrej me zgjidhjet diplomatike të shtetit shqiptar jashtë atdheut, aktivitetin brenda tij e ushtronte Vehbi Dibra, mjaft i sukseshëm në shtrirjen e autoritetit të shtetit të parë shqiptar në të gjitha trevat shqiptare.

6. Kamberi Mois, "Dibra në periudhën e Rilindjes Kombëtare Shqiptare", Maluka, Tiranë, 2012, f. 176.

7. M. H. D. Fondi Dosje Patriotësh, *Vehbi Dibra*, dosja, nr. 598.

8. A.Q.SH. - Fondi 71, D 1, Përkthim nga turqishtja.

9. Zani i Naltë, viti 1937.

10. A.Q.SH. - Fondi - 245, D. 2, f. 6, viti 1912.

11. A.Q.SH. - Fondi 32, D. 26, f. 133.

12. Valentina Duka - "Histori e Shqipërisë 1912-2000", Tiranë: Shblu, 2007, f. 19.

13. *Histori e Popullit Shqiptar*, Vëll. II, Tiranë: Toena 2002, f. 511.

14. Xhafa Bajram, "Historia e Shqipërisë, periudha e pavarësisë", Shkodër, 2006, f. 16.

15. Valentina Duka, "Histori e Shqipërisë 1912-2000", Tiranë: Shblu, 2007, f. 24.



1

INAUGUROHET XHAMIA E RE "BRRAKË", TIRANË

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, së bashku me Ambasadorin e Katarit, z. Ali Bin Hamad Al- Marri, Donatorin, z. Abdul Razak Abdul Xhelil Al Abdul Gani, Myftiun e Tiranës, z. Lauren Luli, Drejtorin e "Qatar Charity Albania", z. Mahmud Abas Shakir, Drejtorin e Fondacionit "Mirënjohja", z. Samet Shehu, si dhe me dhjetëra besimtarë të pranishëm të zonës, hapën dyert e xhamisë së re të Brrakës duke prerë në mënyrë simbolike shiritin e inaugurimit.

Ceremonia u hap me leximin e disa ajeteve nga Kurani Famëlartë, për të vijuar më tej me fjalën përshëndetëse të Kryetarit Spahiu, i cili falenderoi donatorin për këtë kontribut kaq domethënës në shërbim të Islamit dhe u bëri thirrje besimtarëve ta frekuentojnë e ta pasurojnë atë çdo ditë me adhurime ndaj Krijuesit të Gjithësisë.

Ndërsa donatori, i cili bëri të mundur rindërtimin e kësaj xhamie, u shpreh mirënjohës për bashkëpunimin mes palëve, bashkëpunim ky i cili i hapi rrugë rindërtimit të xhamisë së Brrakës nga e para. Ai shprehu kënaqësinë e tij në mundësinë për të kontribuar me një vepër kaq të dobishme për besimtarët myslimanë dhe për qytetin e Tiranës.

Në përfundim, besimtarët e pranishëm falën bashkërisht namazin e xhumasë.

Xhamia "Brrakë" u ndërtua nga "Qatar Charity Albania", Allahu e shpërbleftë donatorin në të dy botët!





2

KONFERENCA NDËRKOMBËTARE ME TITULL: "FETVAJA DHE OBJEKTIVAT E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM"

Nën kujdesin e Presidentit të Republikës Arabe të Egjiptit, SH.T.Z. Abdel-Fattah al-Sisi, dhe organizimin e Myftinisë së Egjiptit, u zhvillua konferenca ndërkombëtare me titull: "Fetvaja dhe objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm".

Kjo konferencë, e zhvilluar në Kairo në datat 17/18 Tetor, mbledhi së bashku studiues, akademikë, përfaqësues të institucioneve fetare dhe përfaqësues politikë nga 91 vende të ndryshme të botës.

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, mori pjesë në këtë konferencë me ftesë të posaçme nga Myftiu i Egjiptit, Dr. Shawki Allam, me të cilin ai zhvilloi edhe një takim, ku diskutuan mbi pikëpamje të ndryshme të marrëdhënies institucionale mes dy palëve.

Gjatë punimeve të kësaj konference, Kryetari Spahiu, zhvilloi takime edhe me personalitete të tjera pjesëmarrëse, ndër ta edhe me Myftiun e Bosnjes, Husein ef. Kavazović





3

MOMENTE NGA MBRËMJA FETARE KUSHTUAR PROFETIT MUHAMED (A.S.)

Mevludi në xhaminë Et'hem Beu.

Të pranishëm për të ligjësuar mbi aspekte të ndryshme të jetës dhe veprës së Profetit tonë të dashur, ishin; Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, imami i xhamisë, Elton Karaj si dhe imamët Munir Salkurti, Erjol Haxhiu, Abdullah Ziba, hafizi Enes Hyka dhe muezinët Osman Kabili dhe Ahmed Shehi.

Gjatë mbrëmjes fetare, e cila u zhvillua fill pas namazit të Akshamit, më datë 21.10.2022, u mbajtën ligjërata rreth jetës dhe veprës së Profetit (a.s.) nga kryetari dhe imamët, u këndua Kuran dhe pjesë nga mevludi gjithashtu.





4

REALIZOHET PROJEKTI I RADHËS HUMANITAR NË BASHKËPUNIM ME ORGANIZATAT "SWISS BARAKAH CHARITY" DHE "MARIONNAUD"

Në kuadër të projekteve humanitare të shumta në mbarë vendin, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, me mbështetjen e organizatave "Swiss Barakah Charity" me qendër në Zvicër dhe "Marionnaud" me qendër në Francë, dhuruan 4 pajisje eko-skaner (në gjendje optimale pune) dhe më shumë se 40 mijë maska të cilësisë së parë, për spitalet publike dhe stafet përkatëse në Elbasan, Cërrik, Gramsh, Dimal (Ura Vajgurore).

"Institucionet shëndetësore janë vatra të jetës dhe sakrificave të mëdha dhe për hir të saj edhe ne besimtarët myslimanë e dimë shumë mirë dhe e vlerësojmë lart rolin e të gjithë punonjësve nëpër këto institucione kaq jetike për të gjithë shoqërinë." – u shpreh Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, gjatë ceremonisë së dorëzimit të këtyre pajisjeve në ambientet e spitalit rajonal të Elbasanit.

Në këtë ceremoni gjithashtu ishin të pranishëm Myftiu i Elbasanit, z. Agim Duka, Myftiu i Peqinit, z. Armand Islami, Myftiu i Gramshit dhe njëkohësisht koordinatori i këtij projekti, z. Ermir Gjana, znj. Majlinda Perriu, prefekte e qarkut të Elbasanit, Kryetari i Bashkisë së Elbasanit, z. Gledian Llatja, Kryetari i Bashkisë së Cërrikut, z. Andis Salla, Kryetari i Bashkisë së Gramshit, z. Klodian Taçe, si dhe drejtorët e spitaleve përfituese.

Në fjalën e tyre, krerët e institucioneve vendore të këtyre rretheve, shprehën falenderimet e tyre për institucionin e KMSH-së që bëri të mundur koordinimin e këtij projekti dhe dy organizatat ndërkombëtare që dhuruan pajisjet.

Pas ceremonisë së dorëzimit, këto pajisje u shpërndanë në spitalet e sipërpërmendura ku u morën në dorëzim nga stafet përkatëse për t'u vënë në shërbim të qytetarëve.





Themeli i Islamit

ËSHTË KUPTIM DHE BESIM

Islam do të thotë dorëzim i robit të Allahu, ndjekje e urdhreve të Tij, hyrja në një rrugë të qetë, në paqe e siguri dhe ecje drejt suksesit e shpëtimit. Islam është emri i fesë së zbritur nga Zoti me bazat e mbështetura në mesazhet e Allahut, të kumtuar e të përfaqësuar si dhe të jetuar vetë e të mundësuar edhe për të tjerët për t'u jetuar, nga profeti Muhamed (a.s.). Feja islame përbëhet nga konkluzionet besimore - itikadi (bazat e besimit), praktika-ameli (adhurimet, marrëdhëniet civile, penaliteti), morali-ahllaku (moraliteti-etika).

Themeli dhe kreu i Islamit është besimi dhe kuptimi. Pra, besimi në të vërtetën hyjnore në mënyrë të palëkundur, pa i dhënë mundësi të kundërtës dhe lidhja e zemrës pas së vërtetës, Zotit. Kurse maja, është zbatimi i përgjegjësi me ndjeshmërinë më të lartë sikur ta shohësh Zotin para, ta shohësh Atë sikurse Ai të vrojton ty, që sipas terminologjisë quhet ihsan, mirësi, si dhe kryerja e çdo akti me boshft fitimin e miratimit dhe pëlqimit të Zotit, që terminologjia e definon si ihlas, principialitet dhe sinqeritet.

Me institucionin e fesë kuptojmë vënien në jetë dhe praktikimin e besimit fetar, pra përfaqësimin dinjitoz dhe zbatimin në jetë e urdhreve të Zotit. Personi që i beson Islamit quhet musliman, që nënkupton dorëzimin dhe

nënshtrimin e njeriut ndaj mesazheve të Zotit, e cila përfaqëson qetësinë, paqen, suksesin dhe shpëtimin. Këtë emërtim, besimtarit ia ka dhënë Allahu i lartë në Kuran: "Është Ai i cili jua ka dhënë këtë emër edhe më parë, edhe në Kuran". (22/78)

Fjala mu'min (besimtar) do të thotë njeri i besueshëm, me personalitet të shëndoshë, që jep siguri, që i beson Andërgjegje dhe e ndjen me zemër. Me kuptimin e vet të posaçëm, është njeriu që i beson mesazhit që kumtoi profeti Muhamed (a.s.). Megjithatë emërtimet mu'min dhe muslim kanë dallim nuancash kuptimore mes tyre, përdoren në vend të njëri-tjetrit. Po që se i shtjellojmë pak këto përkufizime, mu'mini ose besimtar, për nga këndvështrimi i faktit që me arsyen e shëndoshë dhe mirëkuptimin, me zgjuarsinë dhe aftësinë parashikuese, me mendjen e pastër e të kthjellët të ndriçuar nga revelata hyjnore, me botëkuptimin e gjerë dhe objektiv, me vështrimin e shëndoshë dhe gjithëpërfshirës, me ndjeshmëri dhe korrektesën në përgjithësi, me vendosmërinë dhe qëndrueshmërinë kundër të këqijave, gjatë gjithë jetës është në ndjekje të virtutit dhe punëve të larta e sublime.

Me natyrën, ndjenjën, vetëdijen dhe vullnetin që e karakterizon, besimtar mundohet ta mbajë të gjallë



dëshirën për të arritur kompetencën, thelbin dhe kuptimin e thellë të ngjarjeve dhe dukurive në jetën e tij. Ai i bindet Allahut, ka siguri te Ai, dhe mes njerëzve njihet si njeri i besueshëm, që e dëshmon të Vërtetën (Zotin) dhe i mbetet gjithmonë besnik, që njihet si njeri besnik ndaj amanetit dhe kujtohet si njeri të cilit mund t'i drejtohesh gjithmonë për ndihmë, që njihet dhe pranohet si i tillë nga ndërgjegjia publike, që bëhet pretekst kudo që ndodhet e dëgjohet për përmendjen e të Vërtetës dhe që i orienton me fjalët dhe qëndrimet e veta për tek e Vërteta të gjithë ata, që i gjenden pranë ose shoqërohen me të. Për nga këndvështrimi i këtyre fakteve, besimtari, mbështetur në parimin e "përkushtimin gjer në vetëmohim ndaj përkryerjes së fjalës absolute", është një hero i vërtetë i vërtetimit, shpjegimit dhe përfaqësimit të besimit.

Fetar, njeri fetar, është personi që e beson dhe e përfaqëson fenë islame me të gjitha elementet e saj të besimit, veprimit dhe moralit. Akti (adhurimor ose civil) pa besim është hipokrizi, kurse besimi pa akt është defekt (mangësi gjer në mëkat). Ndërsa hipokrizia është një mohim (kufr) i fshehtë me pamundësi faljeje. Ndryshe nga hipokrizia, defekti dhe mëkati e kanë gjithmonë të hapur mundësinë e faljes me anë të pendimit dhe

rikthimit kah Zoti. Nisur nga kjo, po që se dikush, edhe pse nuk i kryen detyrat fetare, pra nuk e vë fenë në jetë, por nuk e nënvleftëson atë, për këtë person duhet menduar gjithmonë pozitivisht dhe nuk duhet nxituar për të konkluduar si mohim (kufr) për të. Përkundrazi, po që se dikush jo vetëm që nuk i kryen detyrat fetare, por edhe i nënvleftëson dhe i përbuz myslimanët ngaqë janë myslimanë, sigurisht që për të është e pamundur që të mendohen të njëjtat gjëra pozitive!

Allahu ia ka favorizuar njerëzimit një udhëzues që do ta çonte njeriun në këtë botë dhe në jetën e pasme në qetësinë e përhershme me kënaqësinë pa dhimbje, me anë të kuptimit dhe përfaqësimit të Profetit Muhamed (a.s.). Islami është emri i këtij favoriti dhe e kësaj mirësie të pashoqe. Në këtë fe, sipas arsyes së shëndoshë dhe mendimeve të drejta, jo vetëm nuk ka ndonjë boshllëk lidhur me kërkesat e njeriut, por as gjendet ndonjë kundërtënie në urdhrat e krijimit dhe në interpretimin e tyre. Veçanërisht krahas të gjitha këtyre, me premtimet për lumturinë shpirtërore, pëlqimin e Zotit dhe mundësinë për ta parë Atë, Islami është dhe mbetet një sistem hyjnor i zgjedhur, i planifikuar sipas karaktereve, kapaciteteve, qëllimeve dhe prirjeve njerëzore.

Modeli Islam

DËR EMANCIPIMIN E GRUAS

Në lidhje me çështjen e gruas dhe me emancipimin e saj, shumica e mendimtarëve dhe e të urtëve nuk kanë patur kundërshti mendimi se gruaja ka qenë rënduar me peshat e padrejtësive dhe të kufizimeve gjatë historisë, madje edhe në shekullin tonë aktual dhe në të gjitha qytetërimet, më shumë se sa kanë qenë rënduar burrat. Si rrjedhojë, shumica e mendimtarëve nuk do të kenë mospërputhje mendimi se gruaja ka një "Kauzë", dhe se emancipimi i saj- edhe në qoftë se ka lidhje me emancipimin e burrit- kërkon shumë dallim, shumë specifikim dhe shumë interpretim. Por ama çështja që shkakton shumë mospërputhje mendimi- madje shkakton polemika- në shkallë botërore është "modeli më i mirë" që ka realizuar emancipimin e vertetë të grave.

Ndodhet një model ekstrem arab, modeli i lëvizjeve feministe arabe të cilat kërkojnë e synojnë përqendrimin e

femrës rreth vetes së saj në një botë të zbrazur nga burrat, në të cilën gruaja ngre krye kundra burrit, kundra natyrës së shëndoshë mbi të cilën Allahu i ka krijuar njerëzit, dhe kundra të gjitha vlerave dhe feve. Ai është një model që arriti në ekstremin e tij dhe në çrregullimin e tij deri në skajin e çmendurisë.

Ndodhet një model tjetër, ai i ngurtësisë dhe i traditës i cili ia ka ngarkuar dhe ia ngarkon fesë traditat e amullta, duke i rrënjësuar ato duke i ngulitur dhe duke i shenjtëruar deri në atë masë, sikur emancipimi i gruas në këtë model të ishte emancipimi i saj i vetëm prej të gjitha thirrjeve dhe çështjeve të emancipimit.

MODELI I TË MESMES SË ARTË NË EMANCIPIMIN E GRUAS

Ndodhet një model i mesëm i ekuilibruar i cili shpreh

realitetin e emancipimit islamik për gruan. Është ai model i cili nisat nga tekstet, logjika dhe Fikhu i Kur'anit Kerim për emancipimin e gruas, për dhënien e të drejtave të saja dhe për barazinë midis grave dhe burrave, të cilat Allahu i vendosi midis tyre kur i krijoi ata të gjithë nga një njeri i vetëm, dhe që vendosi barazi midis atyre të gjithëve në mbajtjen e Amanetit të zhvillimit dhe të ndërtimit të kësaj toke kur Ai i bëri të gjithë ata si Kalifë trashëgues në mbajtjen e këtij Amaneti.

Gjithashtu Ai vendosi barazi midis tyre në nderim kur Allahu i nderoi të gjithë bijtë e Ademit në kapacitete, në detyrime, në llogari dhe në shpërblim e ndëshkim, por duke ruajtur natyrën e dallimit midis femrës dhe mashkullit me qëllim që të plotësohet mirësia e lumturisë njerëzore duke nxitur e motivuar secila palë palën tjetër të dalluar prej saj-sepse nëse pala tjetër do të ishte e njëjtë, atëherë nuk do të kishte "tjetër" dhe nuk do të kishte të dëshirueshëm për të cilën rrahin zemrat - ; dhe me qëllim që kjo barazi të jetë në moral , në mbajtjen e amanetit, në nderim , në kapacitete, në detyrime, në llogari, në shpërblim e ndëshkim dhe në pjesëmarrje duke qenë solidare në përmbushjen e detyrave të përgjithshme shoqërore; dhe që kjo barazi të jetë barazia e plotësisht të dy pjesëve të dalluara, dhe jo barazia e dy palëve me të kundërta të ngjashme dhe të papajteshme.

Ky model i mesëm nisat nga tekstet, logjika dhe Fikhu i Kur'anit Kerim, i cili e bëri burrin pjesë të gruas dhe gruan pjesë të burrit: "Unë kurrë nuk do lejoj që të humbasë vepër e kujtdo prej jush , mashkull apo femër.

Ju jeni (pjesëtarë të barabartë) prej njëri tjetrit" (Al'imran, 3:195). Kështu çdo palë është veshje për palën tjetër: "Ato janë veshje për ju, edhe ju jeni veshje për ato" (el-Bekareh, 2:187). Sigurisht ata i janë hapur plotësisht njëri tjetrit: "Ndërkohë që ju jeni hapur aq shumë tek njëri tjetri dhe në të njëjtën kohë ato kanë marrë prej jush një beslidhje të fortë e të shenjtë" (Nisaë, 4:21).

Lidhjet e kësaj beslidhje të shenjtë- Besëlidhje të Natyrshmërisë-ngrihen mbi bashkimin e të gjithë atyre mbi bazën e dispozitave ligjore të besëlidhjes, përmbushjes së detyrimit, dashurisë, mëshirës dhe të prehjes: "Dhe nga shpalljet dhe Shenjat e Tij është se Ai krijoi për ju grana në mesin tuaj, që ju të mund të gjeni prehje tek ato dhe Ai vendosi mes jush dashuri e mëshirë" (er-Rum, 30:21). Ky model i mesëm nisat gjithashtu për sa ka të bëjë me emancipimin e gruas dhe me dhënien e të drejtave asaj; bashkë me qënien e saj femër- nga fakti se ai jep lumturi kur ajo është e drejtë dhe e bën atë të ndjehet krenare dhe të rivalizojë për qënien e saj femër, si dhe e tëhuan atë, e largon dhe e bën të ndjehet e turpëruar prej të "vepruarit si burrë", ashtu siç e gëzon ky model i mesëm burrin e drejtë duke e bërë atë krenar dhe të matet për burrërinë e tij, si dhe e largon atë dhe e tëhuan prej "të vepruarit si femër dhe prej qënies si femër". Ky model i mesëm nisat gjithashtu nga vënia në zbatim të Praktikave Profetike ndaj teksteve, logjikës, dhe Fikhut të Kur'anit Kerim, ato

praktika të cilat e emancipuan gruan muslimane, dhe e shpëtuan atë prej "varrosjes për së gjalli" materialisht e shpirtërisht; dhe e bëri atë një fuqi vepruese në ndërtimin e familjes, të shtetit, të Kombit dhe të qytetërimit si dhe pjesëmarrëse në fushat e tjera të ngritjes së Fesë dhe të dynjasë qysh prej momenteve të para të ndriçimit të diellit të Islamit. Ky model i mesëm gjithashtu nisat edhe nga zelli Islamik modern e bashkohor i cili i jep gruas kujdesin që ajo e meriton si një palë kryesore në projektin e ringjalljes së kërkuar të cilën e synojnë lëvizjet e rigjallërimit, të zellit dhe të ripërtëritjes duke u mbështetur në Kur'anin Kerim dhe në zbatimin e praktikave Islamike për emancipimin e gruas përballë të gjitha konceptimeve dhe modeleve të ekstremit Islamik dhe të ekstremit laik.

Modeli i mesëm, të cilin e përfaqëson Ruga e mesme e artë Islame në emancipimin e gruas dhe në dhënien e të drejtave të saja, matet dhe e bën botën të krenohet me pionieret feministe të cilat i emancipoi Islami qysh prej epokës së Profetit dhe deri në shekullin në të cilin ne jetojmë. Ky model bën thirrje që këto gra pionierie të merren si shembull i mirë për t'u ndjekur.

GRATË PIONIERS NË FILLIMIN E ISLAMIT

Hatixheja e bija e Huvejlid, Allahu qoftë i kënaqur prej saj, është një model prej modeleve të rezultateve të mira të këtij emancipimi islamik për gruan. Ajo i parakaloi të gjithë burrat në besimin me thirrjen e re Islame të sapa shfaqur. Ajo ishte përkrahëse- me mendje, urtësi, pasuri dhe gjithashtu edhe me ndjenja fisnike- ndaj Profetit të Islamit, ndaj thirrjes së tij dhe ndaj Ummetit të tij, saqë viti i vdekjes së saj ishte "viti i pikëllimit" dhe i zisë për të gjithë Komunitetin besues.

Esmaja, e bija e Ebu Bekër Siddik, Allahu qoftë i kënaqur prej saj, ishte një model prej modeleve të rezultateve të mira të këtij emancipimi. Ajo ruajti amanetin e sekretit të planit të Hixhretit Profetik nga Meka në Medine, plan i cili ishte më i rëndësishmi i ndryshimeve në historinë e thirrjes Islame, të shtetit dhe të Ummetit. Ajo mori pjesë në zbatimin e këtij plani të kësaj ngjarjeje shumë të rëndësishme. Ajo e mbështeste bashkëshortin e saj hero Zybejr Ibn Avam, ia rregullonte mirë shtëpinë, kultivonte për të në fushë, ushqente Kalin e tij të luftës dhe luftoi së bashku me të në disa betejat. Ajo e rriti djalin e tij Abdullah ibnu Zybejr-in dhe e edukoi me ndjenjën e heroizmit, vetëmohimit dhe të martirizimit; dhe kundërshtonte e përballë me mizorët si shembulli, Haxhxhaxh ibn Jusuf eth-thekafj. Megjithatë, Esmaja mbeti femra që vishej me modesti Islame dhe orientale. Ajo nuk vishte rroba që e zbulonin ose që ishin të tejdukshme. Ajo ruante dhe kujdesej për ndjenjat e xhelozisë së skajme të bashkëshortit të saj.

EL-SHIFA' e bija e Abdullah el-Kurejsh, el-Adevijeh - Allahu qoftë i kënaqur prej saj ishte një rezultat prej rezultateve të mira të këtij modeli islamik për emancipimin e grave. Ajo ishte nga të parat në Islam. Ajo lidhi besën për të hyrë në të, në Ummetin e tij dhe në shtetin e tij. Ajo u

dallua nga mençuria, nga mendimi dhe nga urtësia, si dhe punoi për të dhënë mësim në lexim e shkrim, saqë ishte mësuesja e Hafsas, nënës së besimtarëve. Ajo transmetoi hadithet e të Dërguarit të Allahut. Ajo diskutonte me të dhe ndonjëherë e qortonte dhe i Dërguari i kërkonte falje. Ajo arriti në pushtet e në shtet deri aty saqë Umer Ibn Hattabi e emëroi atë me "Detyrën" e inspektorese së financave, domethënë, në ministrinë e drejtësisë dhe të marrëdhënieve tregtare. Ajo ushtronte kontroll dhe kërkonte llogari dhe bënte dallim midis tregtarëve që shisnin dhe blerësve në treg nga burrat dhe gratë.

Aisheja, e bija e Ebu Bekrit es-Siddik- bashkëshortja e Profetit Muhammed, paqja dhe bekimet qofshin mbi të, dhe nëna e besimtarëve, Allahu qoftë i kënaqur prej saj, është një rezultat prej rezultateve të mira të këtij emancipimi islamik për gratë. Gruaja e dashur dhe fisnike ishte transmetuese e Haditheve Profetike dhe ruante në kujtesë Sunnetin Profetik. Ajo ishte fekihe që verifikonte e rishikonte rrëfyesit, lexuesit, ekspertët e fikhut, dhe muxhtehidët -interpretuesit e ligjit të shenjtë. Ajo gjithashtu ishte konsulente në çështjet e përgjithshme dhe ishte shijehollë për artet që i shfaqnin një grup artistik- prej Habeshive- në Xhaminë e Profetit. Ajo ishte ushtruese e sportit të vrapimit me bashkëshortin e saj, mbi të qofshin paqja dhe bekimet, gjatë udhëtimit për në betejë ose në luftë.

Hafsa e bija e Umer Ibn Hattabit, bashkëshortja e Profetit dhe nëna e besimtarëve, Allahu qoftë i kënaqur prej saj, ishte një model prej rezultateve të mira të këtij emancipimi islamik të gruas. Ajo ishte nga të parat që pranoi Islamin në Mekë. Ajo emigroi me fenë e saj në Medinenë e Ndriçuar. Ajo ishte poete, predikuese elokumente dhe një transmetuese e haditheve Profetike. Ummeti ia besoi asaj ruajtjen e Kur'anit kur Muslimanët i grumbulluan fletët e tij si "Mus'haf" në kohën e Kalifatit të Ebu Bekër es-Siddik. Ajo e ruajti Kur'anin derisa ia dorëzoi Kalifit Uthman Ibn Affan, ku prej tij u kopjuan Mus'hafët që u shpërndanë nëpër vende të ndryshme. Ajo morri pjesë në konsulta dhe jepte mendime lidhur me organizimin e këshillit Islamik pas martirizimit të babait të saj Farukut. Ajo shkroi proza e poezi dhe u predikonte njerëzve në vendet e Ebu Bekrit dhe të Umerit. Ajo fliste për rrugën e Islamit me përzgjedhjen konsultative të kalifëve, të besëlidhjes dhe të konventave midis Ummetit dhe atyre.

Nesibe bintu Kaëb el-Ensarijeh- Umm Amareh- Allahu qoftë i kënaqur prej saj, ishte një frut i bërë i ndritshëm prej frutave të këtij emancipimi. Ajo mori pjesë në besëlidhjen e Akabes, të Asamblesë kushtetuese të shtetit Islamik. Së pari ajo ushtroi nën hijen e Islamit dhe të emancipimit të tij për gruan vlerën e sundimit politik para katërbëdhjetë shekujve dhe mori pjesë në besëlidhjen e Ridvan- nën pemë- në vitin e Hudejbies (viti i 6 sipas Hixhretit) për "Betejë e luftë", kur u hap fjala se Kurejshët kishin vrarë përfaqësuesin e muslimanëve tek ata, Uthman Ibn Affanin. Umm Amareh ishte prej atyre që përmbushën premtimet që i kishin dhënë Allahut.

Në ditën e Uhudit ajo ishte midis atyre më pak se dhjetë veta që i bënë rezistencë ushtrisë së politeistëve dhe që mbrojtën të dërguarin e Allahut, mbi të qofshin paqja dhe bekimet. Në atë ditë Profeti e shikoi atë ndërsa i ishte thyer dhëmbi dhe i rridhte gjaku, e cila po nxitonte dhe kishte lidhur rrobat në mes dhe po luftonte përpara Profetit duke sfiduar Ibën Kamiet i cili po afrohej drejt të Dërguarit, mbi të qofshin paqja dhe bekimet, duke thënë: Ku është Muhammedi? Mos shpëtofsa gjallë nëse ai shpëton! Profeti e shikoi atë ndërsa ajo mori në shpatullën e saj goditje me shpatë të cilën Ibn Kamieh synoi t'ia drejtonte Profetit. Bashkë me të ishte edhe nëna e saj e cila i fashoi plagën e saj. Gjithashtu me të në këtë luftë të përgjakshme, ishte edhe i biri i saj i cili u gjakos dhe ajo ia fashoi duke ia ndaluar hemoragjinë dhe pastaj kërkoi që ai të ngrihej për luftim. Kur plaga e saj u përkeqësua në shpatull, Profeti i thirri birin të saj: "shiko nënën! Shiko nënën tënde! Fashoje plagën e saj! Allahu ju bekoftë Juve nga Ehlibejti- Familja ime!" Pastaj ai i thirri njërit që po ikte nga lufta që t'i jepte asaj mburojën e tij për t'u mbrojtur me të. Ndërkaq Profeti i tha asaj me habi e admirim: "kush do të mund ta përballonte atë që përballon ti, O Umm Amareh?! Sigurisht pozicioni i Nesibe Bint Kaëb në Ditën e Uhudit ishte më i mirë se filani e filani. Ajo nuk kthehej djathtas e majtas veçse unë e shihja atë duke luftuar përpara meje. Ndërsa ajo, e cila e la fushën e betejës në atë ditë me trembëdhjetë plagë në trup, i tha të Dërguarit të Allahut, mbi të qofshin paqja dhe bekimet: "O Profet! Lutju Allahut që ne të të shoqërojmë ty në Xhennet! Profeti u lut: "O Allah! Bëji ata që të jenë shoqëruesit e mi në Xhennet!" Atëherë ajo tha: "Tani nuk shqetësohem aspak për çfarëdo që mund të më bie mua në dynja".

Esma Bint Jazid Ibn es- Seken el-Ensarijji- Allahu qoftë i kënaqur prej saj- ishte një tjetër nga yjet që i emancipoi Islami dhe që ndriçuan në qiellin e emancipimit të gruas muslimane. Ajo mori pjesë së bashku me Nesibe Bint el-Kaëb el- Ensarij në aktin e themelimit të shtetit të parë Islam në Besëlidhjen e Akabesë. Ajo u martirizua në Ditën e pushtimit më të madh (Pushtimit të Mekës). Ajo luftoi në ditën e Jermukut në pushtimet e Shamit dhe vrau nëntë romakë me shtyllën e çadrës së saj. Ajo ishte prej atyre grave të afta me mendime të shëndosha, me logjikë, urtësi e fe. Ajo ishte predikuese aq elokumente saqë lëkundeshin dërrasat e predikatoreve kur ajo mbante ligjëratë dhe kur ngrihej për të organizuar gratë besimtare. Ajo ishte në krye të lëvizjes për të kërkuar të drejtat që u takonin grave. Ajo madje u quajt në librat e Sunnetit dhe të biografisë me emrin "plotësuesja e grave", domethënë përfaqësuesja ose kryetarja e grave për kërkimin e të drejtave të tyre, sepse ajo shkonte tek i Dërguari i Allahut, mbi të qofshin paqja dhe bekimet, kur ai ndodhej në xhami dhe duke folur në emrin e grave muslimane, tha: "Unë jam Va'fideja- përfaqësuesja e grave që janë pas meje; ato shprehin të njëjtat fjalë që i shpreh unë dhe kanë të njëjtin mendim si unë. Sigurisht Allahu të ka dërguar ty për burrat dhe për

gratë: Kështu që cakto edhe për ne një ditë në të cilën Ti të na japësh ne mësim! " Profeti ua premtoi atyre një ditë në të cilën ai u jepte mësim atyre dhe i udhëzonte. Ajo transmetoi nga Profeti më shumë se tetëdhjetë hadithe. Ato ishin thjesht disa tregues të shembujve nga modelet që mishëruan cilësinë e emancipimit që e realizoi Islami për gruan qysh prej fillimit të misionit Profetik dhe qysh prej lindjes së diellit të qytetërimit Islamik. Në qoftë se këto modele janë dëshmitare dhe dëshmi vërtetësie për cilësinë e emancipimit dhe për modelin e tij, atëherë horizontet e gjëra që i kanë arritur valët e këtij emancipimi dëshmojnë për përgjithësimin e mirësisë që përfaqësohet e shfaqet në të.

PËRQINDJA E GRAVE TË SHQUARA NË QYTETËRIMIN ISLAM

Në Ditën kur Profeti Muhammed a.s.m. kaloi tek Prania e Allahut të lartësuar, Ummeti që hyri në fenë e re dhe që u bënë nënshjetas të shtetit të porsalindur, numëronte rreth 134 000 muslimanë. Kur dijetarët vëzhguan biografitë dhe kategoritë e emrave të figurave të shquara të elitës dhe të ajkës që u edukuan në shkollën e Profetësisë dhe që dalloheshin me talentin e saj në fushat e ndryshme, ata shikuan emrat e rreth tetë mijë personave prej supërelitës, ku midis tyre ishin njëmijë gra. Domethënë, emancipimi islamik për gruan shtyu e nxiti për tek qendra e përgatijeve të kapaciteteve eksportuese dhe drejtuese një të tretën e individëve të elitës dhe ajkës gjatë periudhës së emancipimit islamik në më pak se një çerek shekulli. Ajo është përqindja më e lartë e pionierëve gra në çdo revolucion emancipimi ose në çdo lëvizje për ringritje e ripërtëritje.

Në qoftë se erërat e periudhës së injorancës i rikthyen disa tradita dhe zakone të cilat sunduan shoqëritë para islamit, këto tradita të amullta nuk mundën t'i mposhtnin arritjet e emancipimit islamik të gruas, pavarësisht luftës së tyre ndaj këtyre arritjeve. Shpirti i këtij emancipimi dhe rezultatet e tij të mira mbetën të dalluara deri në shekujt e prapambetjes civilizuese që goditën botën islamik; dhe jeta jonë shoqërore islamike vazhdoi të ishte e mbushur me modele të grave transmetuese të haditheve, fekihe, poete dhe letrare të cilat arritën deri në atë shkallë në dije, saqë prej tyre morën mësim dhe "Autorizim" ose dekret dituror nga ana e tyre një numër prej dijetarëve të mëdhenj të fikhut, të hafizëve, të transmetuesve të hadithit dhe të ripërtëritësve. Kur dijetari i historisë dhe i biografisë së figurave elitare "Umer Rida Kehaleh" shikoi gratë e shquara të cilat patën sukses, u dalluan dhe paraprinë radhët e elitës në historinë tonë të civilizimit, ai shkroi biografinë përmbledhëse të tre mijë grave të shquara vetëm në Gadishullin Arabik, i cili përbën veçse një të pestën e Ummetit islam.

Është e vërtetë se përqindja e elitës dhe e grave të shquara në historinë tonë të civilizimit duhej të ishte shumëfish më e madhe sesa ky numër duke bërë analogji

me sasinë dhe numrin e grave elitare dhe pararojë të kohës së profetit. Por ky numër mbetet dëshmi vërtetësie për modelin islamik në emancipimin e grave dhe medalje nderi për fillimin e qytetërimit islamik me të cilin krenohen e maten të gjitha qytetërimet.

Ky emancipim ka rezistuar i pamposhtur përballë zakoneve dhe traditave të amullta të cilat u kthyen dhe sunduan në epokën e prapambetjes së tij civilizuese, dhe vazhdoi si faktor aktiv në shtrirjen e historisë islame. Pastaj ai u rikthye që të ndriçojë shenjat dalluese në interpretimet e shkollës së rigjallërimit islamik, modern bashkëkohor.

MESAZHI I ISLAMIT ËSHTË MESAZH RIGJALLËRUES

Qytetërimi Islamik është ai që ka mishëruar rigjallërimin Islamik në fusha të ndryshme të novacionit civilizues; sepse Islami është ripërtëritje në këto fusha të ndryshme: "O ju që keni besuar! Përgjigjuni Allahut dhe të Dërguarit të Tij Kur ai (Profeti) ju thërret ju drejt asaj që do t'ju gjallërojë ju..." (el-Enfal, 8:24). Ky qytetërim Islamik ka nxjerrë dijetarë të shquar në fusha të ndryshme të shkencës duke përfshirë astronominë, natyrën, aritmetikën, inxhinierinë, matematikën, mjekësinë, shkencën e farmacisë, etj. Para se të kalonte një shekull nga koha e lindjes së diellit të Islamit, sa të mëdhaja ishin shkencat Juridike të Sheriatit, shkencat njerëzore, sociale, dhe artet dhe letërsia. Ndërsa qytetërimi perëndimor në Evropë mbeti gjashtëmbëdhjetë shekuj para se të dëshmonte një shkencëtar të vetëm në astronomi. Në qoftë se besimi Islam, Fikhu i Daëves Islame dhe këshilli i kësaj daëveje filluan që të gjitha me një grua e cila ishte Hatixheja Bint Huvejlid, Allahu qoftë! I kënaqur prej saj, dhe në qoftë se shkencat Islame njohën pioniere nga gratë qysh prej fillimit të thirrjes Islame dhe përgjatë shtrirjes së historisë së gjatë të saj, qytetërimi perëndimor nuk njohu asnjë shkencëtar në kristianizëm dhe as në teologjinë e tij. Sa për atë të cilën ata e quajtën në rilindjen evropiane si emancipimi i gruas, sigurisht është si ai tjetri - si çlirimi i shkencëtarëve - prej peshave të pushtetit të Fesë, të Kishës dhe të priftërinjve. Si rrjedhojë erdhi reagimi jofetar që ta çlironte gruan prej Fesë në vend që ta emanciponte atë me fe. Për këtë arsye, mesazhi i mendjes së muslimanit është mbrojtja e shoqërisë muslimane që të mos bie në moçalin e traditës, e traditës tjetër arabe, qoftë ajo tradita e modelit ekstrem perëndimor në kundërshtim me natyrën e shëndoshë dhe me vlerat, apo tradita e zakoneve shoqërore të shkuara, që do të ishte e ulët. Kurse në modelin e mesëm Islamik për emancipimin e gruas me Islamin shembullor i cili e emancipon gruan së bashku me ruajtjen e natyrës së dallimit midis femrës dhe mashkullit, atë natyrë mbi të cilën Allahu i ka krijuar njerëzit prej të gjithë meshkujve dhe femrave, ai është një emancipim me të cilin gruaja bëhet e lumtur në vend që të bëhet e mjerë me modelin perëndimor dhe zakonet e amullta të cilat disa ia ngarkojnë të vërtetës së islamit në mënyrë të pasaktë dhe me shpifje.

Përktheu: Jusuf Salkurti

VEÇORITË E SAHABËVE

Sahabët që Allahu (xhel'le xhelaluhu) ia zgjodhi dhe ia dhuroi të Dërguarit të Tij (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) ishin individët më të mbarë në krejt shoqërinë. Edhe Kur'ani Famëlartë e shpreh qartë se umeti i Profetit Muhamed (s.a.s.) është më i nderuari ndër gjithë umetet.

"Ju jeni populli më i mirë i dalë për njerëzimin: (sepse) ju urdhëroni që të bëhen vepra të mira, i ndaloni të këqijat dhe besoni Allahun. Sikur ithtarët e Librit të besonin, do të ishte më mirë për ata; ka prej atyre besimtarë të vërtetë, por shumica e tyre janë larg udhës së drejtë." (Al 'Imran, 3/110)

Sipas asaj që është transmetuar, në kohën e hilafetit, Omeri (radijallahu anhu) ka thënë këto fjalë kur është rrekur që t'i jape kuptim këtij ajeti: "Po të donte Allahu (xh.xh.) në vend të frazës "ju ishit" në ajet, mund të përdorte trajtën e saj "jeni ju" dhe kësodore, në përmbajtjen e këtij ajeti mund të ishin të përfshirë të gjithë. Mirëpo, me atë "ju ishit" del mjaft qartë se me këtë nënkuptoheshin vetëm sahabët. Andaj, kush u ngjan atyre, duke kryer vepra si ato që bënë ata, arrin të bëhet pjesë e bashkësisë më të mbarë, më fisnike e më të përzgjedhur të gjithë njerëzimit."

Në një transmetim tjetër, Omeri (radijallahu anhu), në kohën e Haxhit, pasi kishte parë disa sjellje të pahijshme prej disa njerëzve, u pati lexuar atyre këtë ajet, duke shtuar: "O njerëz, kush dëshiron që të jetë prej asaj bashkësie të cilën e ka përzgjedhur Allahu (xhel'le sha'nuhu), t'i plotësojë të gjitha konditat që parashtron përfshirja brenda saj." Kësodore ai e pati këshilluar popullin e tij, që në çdo veprim, qoftë përse i përket udhëzimit për mirë apo ndalesës nga e keqja, qoftë në çfarëdolloj çështjeje tjetër, ata të merrnin si shembull sahabët, duke bërë çmos që t'u ngjanin atyre sa më shumë.

I Vërteti Allah (xh.sh.), i Cili i njeh më së miri zemrat e njerëzve, zgjodhi pikërisht Muhamedin (s.a.s.), Krenarinë e Njerëzimit, për ta përgëzuar me detyrën e profetësisë. Mandej, sërish duke i vështuar zemrat e njerëzve zgjodhi bashkësinë e sahabëve që të ishte e denjë për të qenë umet i Profetit Muhamed (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), duke bërë që të ishin ata ndihmëtarët e parë të fesë islame, me përfaqësimin sa më të përkryer të asaj që do të ishte feja e madhërisme e Allahut (xh.xh.). Andaj, për sa i përket kënaqësisë së Allahut, kush i pëlqen e i merr shembull sahabët është i pëlqyer, e kush nuk i pëlqen si shembullin, ai nuk mund të jetë i tillë.

Abdullah ibni Omeri (radijallahu anhu), një prej prijësve të sahabëve, teksa flet për ta, ai shprehet me këto fjalë: "Ata që duan të ndjekin një rrugë të drejtë, le të ndjekin rrugën e të parëve të tyre. E ata janë sahabët fisnikë të të Dërguarit të Allahut

(sal'lallahu alejhi ue sel'lem). Ata janë më të mirët e umetit të tij. Më të thellët, për sa i përket dijes, më të pastrit nga zemra; me pak fjalë, njerëz për të cilët është i pamundur kundërshtimi i ndonjë prej cilësive të tyre. Ata janë një shoqëri aq e lartë, sa që Allahu i Madhërisëm i pa ata të denjë për Profetin e Tij më të zgjedhur, Muhamedin (paqja e Zotit qoftë mbi Të). Ishte pikërisht kjo shoqëri me të cilët Ai e mishëroi fenë e Vet. E meqë është kështu, ejani edhe ju, përftoni moral prej moralit të tyre, e ecni në të njëjtën rrugë ku ecën dhe ata, sepse ata nuk janë tjetër, veçse shoqëria më e zgjedhur e Profetit tonë të dashur (sal'lallahu alejhi ue sel'lem). Ju betohem për Zotin e Qabes, se ata patën ecur në një rrugë që vështirë të ketë më të drejtë sesa ajo."

Përmendorja e madhe e dijes, Abdullah ibni Mesudi (radijallahu anhu), i cili ishte i afërm me të, aq sa t'i hynte pa teklif (drojë) në banesë, kaq mprehtë i qorton tabiinët: "Ju si tabiinë ndoshta mund të agjëroni edhe më tepër se sahabët, mund të falni më shumë namaz, e mund të lodheni më tepër sesa ata duke i shërbyer Islamit. Por mos harroni se ata ishin gjithsesi më të mirë e më të mbarë se ju." E kur e pyetën se përse ishte kështu, ai iu përgjigj: "Sepse ata (me zemër) nuk ishin asfare të interesuar për asgjë të kësaj bote, e jashtëzakonisht të dhënë pas jetës së përtejme." Çdonjërit prej dijetarëve ndër sahabë që do t'i bënit një pyetje, përgjigjja që do të merrnit do të ishte përherë e njëjta përgjigje. Gishtërinjtë e tyre tregonin përherë kah varret e Ebu Bekrit dhe Omerit të nderuar (radijallahu anhu).

Një ditë, Aliu i nderuar (radijallahu anhu) u fali besimtarëve namazin dhe iu drejtua xhematit të tij me këto fjalë: "Unë i kam parë sahabët e Profetit tonë të dashur (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) dhe i kam njohur shumë mirë të gjithë një e nga një. E sot unë nuk shoh askënd që t'u ngjajë atyre. Uallahi atyre u shterëj fuqia nga të falurit namaz pareshtur, flokët u djersitëshin e u shprisheshin, ndërsa fytyra u pluhurosej nga tërë ato ulje të njëpasnjëshme në sexhde. E gdhinin çdo ditë, ose duke lexuar Kur'an, ose duke falur namaz. Me t'u përmendur Allahu në praninë e tyre, ata fillonin të lëkundeshin sikur degët e pemëve kur fryjnë erëra të forta. Nga sytë u derdheshin lot sikur të ishte duke rënë shi i dendur, uallahi, ju betohem, aq shumë lot derdhnin, sa që edhe teshat në trup u lageshin. Të më besoni, më vjen keq, por unë besoj se sot njerëzit i kalojnë netët e tyre të topitur e larg kësi ndjenjash." Pasi tha këto fjalë, Aliu (radijallahu anhu) u ngrit për t'u larguar së andejmi, e deri në ditën kur ra dëshmor nga dora e të shturur armik të Allahut, Ibni Mulxhemit.

Shkëputur nga libri "Jeta e Sahabëve 1"
M. Jusuf Kandeheui
Botim i KMSH



32 VJETORI I LIRISË SË BESIMIT

Nëntorët, për shqiptarët dhe për kombin shqiptar, gjithmonë kanë rezultuar përcaktues në fatin dhe në rrjedhën e tyre. Nëntori i vitit 1912 solli pavarësinë dhe çlirimin e vendit, ndërsa një tjetër nëntor që do të mbahet mend në historinë e Shqipërisë, është ai i vitit 1990, ku me plot gojën mund ta quajmë "Nëntori i çlirimit të besimit".

Durimi kishte kaluar kufijtë dhe kështu nuk mund të vazhdohej më. Besimtarët shqiptarë, të etur për besim si dhe për t'iu afruar Zotit nëpërmjet lutjeve, kërkonin dikë që t'i udhëhiqte në këtë drejtim, t'u jepte një dorë që të ndienin pak siguri. Pishtarët ndriçues, udhërrëfyesit e drejtë, ata që ishin të gatshëm për të

rrezikuar jetën e tyre dhe të familjarëve të tyre, si e si të ringjallej fryma e besimit, nuk munguan. Morën riskun përsipër dhe guxuan të përballen me regjimin që u vodhi në mënyrë të padrejtë shumë vite jetë nga jeta e tyre, një regjim i cili tashmë ishte në grahmat e fundit.

Ndryshe nga heronjtë, të cilët marrin këtë status pas sakrifikimit të jetës së tyre për një kauzë kombëtare dhe jo vetëm, në nëntorin e 1990 u shfaq një hero i gjallë, i cili ishte i gatshëm të bëhej kurban, me qëllimin e vetëm që besimi në Zotin e Madhërishëm të rikthehej në jetë nga gjendja e komës në të cilën kishte rënë për dekada me radhë. E ky ishte plaku i urtë dhe i mençur

Hafiz Sabri Koçi, i cili së bashku me bashkëpunëtorë të ngushtë të tij dhe besimtarë të përbetuar, pasi përgatitën terrenin dhe iu mbështetën Zotit të Lartësuar, iu drejtuan Xhamisë së Plumbit në Shkodër, pikërisht më 16 nëntor 1990, për të falur së bashku xhumanë e parë, e cila do të mbetet e paharruar dhe do të gdhendet në historinë e rrugëtimit të besimit islam në trojet shqiptare.

Hapja e Xhamisë së Plumbit ishte shkëndija e parë që dha sinjalin fatlum, se Islami, jo vetëm që nuk ishte harruar, por vazhdonte të ishte i gjallë e i freskët në zemrat e shqiptarëve.

Edhe pse misionarët dhe iniciatorët e këtij hapi iu dorëzuan Allahut për gjithçka që do të ndodhte, prapëseprapë i shqetësonte fakti nëse do të kishin mbështetje nga masa e gjerë e popullsisë. Por pjesëmarrja masive në këtë xhuma të parë i dha zemër dhe ia përforcoi edhe më shumë idenë se besimi dhe lidhja me Krijuesin nuk ishte shkëputur nga mesi i shqiptarëve, edhe pse objektet e kultit u rrënuan apo u tjetërsuan. Ky besim i patundur në Zot, pasi kishte heshtur për vite me radhë, kishte ardhur koha që të fliste, madje me të madhe dhe të dëshmonte ekzistencën e tij.

Në këtë xhuma të parë nuk morën pjesë 10, 100 apo 1000 vetë, por mbi 55.000 vetë, të ardhur jo vetëm nga qyteti i Shkodrës, por nga e mbarë Shqipëria. Ashtu siç ka emrin kjo xhami, Xhamia e Plumbit, ashtu edhe pjesëmarrësit në atë ditë të veçantë ishin të gatshëm që të mirëprisnin plumba, nëse do t'u drejtoheshin, si e si që rruga e drejtë dhe udhëzimi hyjnor, si dhe udha islame në trojet shqiptare të përhapej dhe zgjerohej.

Ishte Shkodra nga ku shpërtheu shkëndija e parë, e cila zgjoi besimin ndër shqiptarë; ishte Shkodra nga ku lindën dhe u brumosën fetarë e atdhetarë të shquar të kombit; ishte Shkodra nga ku rifilloi të kumbojë ezani i munguar i xhamive, i cili ftonte njerëzit për namaz e adhurime; ishte Shkodra nga ku u çua tuneli i errësirës dhe nga ku iu dha fund një nate të stërgjatë dhe nga ku agoi një ditë e re plot shpresë për liri, një ditë e shumëpritur nga çdo plak e i ri, një ditë, pritja e së cilës u duk sikur zgjat në përjetësi. Ashtu siç pas natës vjen agimi, edhe pas robërisë vjen lirimi. Ashtu siç hapen fletët dhe gonxhet e trëndafilut, ashtu filluan të zgjoheshin ndjenjat e besimit në të vetmin Zot në mesin e shqiptarëve në nëntorin e 1990 e në vijim. Ashtu siç pas një dimri të acartë dhe të gjatë kur vjen pranvera me freskinë dhe kaltërsinë e saj, i tillë ishte rikthimi i Islamit ndër shqiptarë.

Sërish erdhi nëntori... edhe ky nëntor është i veçantë, pasi shënon plot 27 vjet rrugëtim drejt Zotit, drejt vetes dhe drejt njëri-tjetrit. Gjatë këtyre viteve u rindërtuan dhe u risollën në jetë qindra shtëpi të Zotit, që u rrënuan dhe shkatërruan nga njerëz pa shpirt. Këto qindra xhami që u meremetuan, rikonstruktuan

apo rindërtuan nga e para, rilidhën tokën me qiellin, njeriun me Krijuesin e vet, përçuan lutjet e robërve drejt Mbretit të tyre dhe sollën nga lart mëshirën e Mëshirëmadhit dhe begatitë e Tija të panumërta.

Minaret që u shembën u ringritën sërish, madje jo vetëm ato, por edhe shumë e shumë të tjera. Ëmbëlsia e thirrjes së ezanit që buron prej tyre tashmë pushton çdo skaj të Shqipërisë. Ato i thërrasin njerëzit drejt një ushqimi, që ka më shumë vlerë sesa ushqimi trupor, ushqim që mbush boshllëqet e shpirtit dhe mban zemrën gjallë.

Nëse para 32 vitesh dolën në skenë qindra besimtarë, tashmë numri i tyre është shumëfishuar, saqë hapësirat e xhamive nuk janë të mjaftueshme. Edhe trotuaret dhe oborret përreth xhamive janë tej mase të mbushura për çdo të xhuma. Edhe sheshet më të mëdha të qyteteve nuk mjaftojnë dhe kjo dëshmohet çdo bajram. Njerëzit u lodhën nga gënjeshttrat, mashtrimet dhe iluzionet dhe u rrekën drejt të vërtetës, e cila i solli në Islam, aty ku e ndiejnë veten të vlerësuar dhe të barabartë.

Kushdo që është munduar ta shuajë dritën e Allahut, nuk ia ka dalë dot, pasi vetë Zoti e plotëson dhe e çon deri në fund dritën e Tij, edhe nëse këtë e urrejnë mohuesit dhe mosbesuesit. Edhe në Shqipërinë tonë, shumë u munduan ta shuajnë këtë dritë, të largojnë çdo llambë dhe kandil të kësaj drite nga familjet shqiptare, por nuk ia dolën dot, pasi dielli i besimit dhe hëna e udhëzimit, që mbretëronin në zemrën dhe shpirtin e të devotshmëve, nuk mund të mbuloheshin me shoshë, dhe ishin shumë më të fortë se çdo tentativë e keqbërësve. Ai (Allahu) që ngjall të vdekurin dhe përtërin tokën mbasi të jetë bërë shkrumb e hi, ishte Ai që rindezi fitilat e vetëdijes dhe të identitetit fetar dhe kombëtar të çdo shqiptar.

U mbushën plot 32 vjet që shqiptarët agjërojnë të lirë, pa pasur frikë nëse i zbulon apo nëse i dënon dikush. U mbushën plot 32 vjet që shtëpitë e Allahut (xhamitë) hapin dyert e tyre dhe mirëpresin besimtarë. U mbushën plot 32 vjet, që shqiptarët deklarojnë lirisht dhe të pakushtëzuar përkatësinë e tyre fetare, pa e pasur frikën dhe shqetësimin nëse burgosen, diskriminohen apo internohen. U mbushën plot 32 vjet që shqiptarët myslimanë e të krishterë jetojnë si vëllezër nën një flamur dhe në një vatan.

I drejtohem i falënderime të përzemërta Allahut të Lartësuar për këtë fitore madhështore, si dhe lutemi për të gjithë ata që kontribuuan me veten e tyre, familjet dhe pasuritë e tyre për rimëkëmbjen e lirisë së besimit. Përveç dy bajrameve dhe xhumasë, që konsiderohen si festa zyrtare të besimtarëve myslimanë, festë mund të konsiderohet edhe triumfi i lirisë mbi robërinë, kështu që le të urojmë njëri-tjetrin me urimin:

GËZUAR 32-VJETORIN E PAVARËSISË SË BESIMIT!

A e kuptojnë ç'po ndodh me ta?



Mendimi për pranimin e Islamit më dukej si aventura nëpër urë, mbi humnerën ndërmjet dy botëve tjetërfare; urës aq të gjatë, saqë duhet të arrihet pika nga e cila s'ka kthim para se skaji tjetër të bëhet i pashmangshëm. Kam qenë krejtësisht i vetëdijshëm se, nëse bëhem mysliman, më duhet medoemos që të kthehem nga bota në të cilën jam rritur. Kurrfarë shtegdalje tjetër nuk ishte e mundur. Vërtet nuk mund të ndiqet thirrja e Muhamedit a.s. e njëkohësisht të mbahen lidhjet e mia të brendshme me shoqërinë në të cilën sundojnë koncepte diametralisht të kundërta. Por, a është njëmend Islami shpallje e Zotit apo vetëm urtësi e njeriut të madh, por megjithatë – njeri?

Një ditë – ka qenë shtator 1926 – Elza dhe unë u gjendëm në hekurudhën nëntokësore berlinoze. Shikimi im ra rastësisht te një njeri i veshur mirë përkundër meje, dukej qartë se ishte afarist i pasur, me çantë të shkëlqyeshme prej lëkure mbi gjunjë dhe me unazë të madhe diamanti në dorë. Mendova se figura e pashme e këtij njeriu, pajtohej mirë me fotografinë e prosperitetit që takohej kudo në Evropën Qendrore ato ditë; prosperiteti, që bie më tepër në sy, ka ardhur pas viteve të inflacionit, kur tërë jeta ekonomike ka qenë, sipas rregullit, rrëmujë dhe mjerim i plotë. Shumica e njerëzve kanë qenë të veshur e të ushqyer mirë, kurse njeriu përballë meje nuk bënte kurrfarë përjashtimi nga kjo. Por kur pashën fytyrën e tij, nuk më dukej se shikoja personin e lumtur. Dukej i brengosur, dhe jo vetëm i brengosur, por fort i trishtuar, me sytë që zgurdullojnë në zbrazëti dhe skajet e buzëve të lëshuara si në dhimbje – por jo dhimbje trupore. Duke mos dashur të jem i panjërëzishëm, i ktheva sytë dhe pashë pranë tij një zonjë elegante. Edhe ajo kishte çuditërisht çehre jo të lumtur të fytyrës, sikur po kalonte apo po përjetonte diçka që po i shkaktonte dhimbje; megjithatë, buzët e saj qenë të shtrënguara sikur po qeshte, dhe, jam i sigurt, dukej mjaft artificiale. Atëherë fillova të shikoja përreth të gjitha fytyrat e tjera, - fytyrat e njerëzve të veshur mirë, dhe pothuaj në secilin prej tyre kam mundur të vërej çehre të vuajtjes së fshehtë, ashtu të fshehtë, sikur pronari i fytyrës nuk ka qenë as i vetëdijshëm për këtë.

Kjo njëmend ishte e çuditshme. Kurrë më parë nuk kam parë aq shumë fytyra jo të lumtura rreth vetes; ose ndoshta kurrë më parë nuk kam kërkuar atë që tash aq zëshëm prej tyre ka folur. Përshtypja ka qenë aq e fuqishme, saqë këtë ia thashë Elzës; edhe ajo filloi të shikonte rreth vetes me syrin e kujdesshëm të piktorit kompetent për studimin e tipareve të fytyrave njerëzore. Atëherë m'u kthye mua dhe tha: "Ke të drejtë. Ata të gjithë duken sikur po lëngojnë nga mundime të tmerrshme... Pyes veten: A janë të vetëdijshëm se ç'po ndodh me ta?"

Jam i sigurt se nuk e dinë, siç po e bëjnë këtë, pa kurrfarë besimi në të vërtetat, të cilat obligojnë pa

kurrfarë caku, pos dëshirës që ta ngrenë "standardin e tyre jetësor", pa kurrfarë shprese, vetëm për të siguruar më shumë përparësi materiale, më shumë gjëra dhe mbase më shumë fuqi.

Kur u kthyem në shtëpi, rastësisht pashë në tavolinën time Kur'anin e hapur, të cilin kam qenë duke e lexuar më parë. Mekanikisht e mora që ta lija në vendin e vet, por pikërisht kur dëshirova ta mbyllja, shikimi më ra në faqen e hapur dhe lexova:

"Juve ju shqetësoi përpjekja për shumimin (e pasurisë, fëmijëve, pozitës". / Derisa të vizitoni varret. / Jo (nuk duhet kështu)! Ju shpejt do ta kuptoni! / Përsëri jo! (nuk duhet kështu)! Ju shpejt do ta kuptoni / Po, jo! Po ta dinit me bindje të vërtetë (përfundimin e fundit të grumbullimit të pasurisë, ju nuk do të ishit kaq të etur e nuk do të mundoheshit kaq shumë për këtë botë / Vërtet që do ta shihni Zjarrin flakërues (të Xhehenemit). / Dhe përsëri pra, do ta shihni atë me shikim të qartë e të vërtetë! / Pastaj atë ditë ju do të pyeteni për të mirat (që iu dhanë pas tyre në dynja)". (Tekathur, 1-8)

Për një çast kam mbetur pa frymë. Mendoj se libri m'u drodh në duar. Atëherë ia zgjata Elzës: "Lexoje këtë. A nuk është kjo përgjigja e asaj që kemi parë në hekurudhën nëntokësore?"

Kjo ishte përgjigjja aq vendimtare, sa të gjitha dyshimet befasisht u zhdukën. Tash e kam kuptuar, jashtë çdo dyshimi, se Zoti e ka inspiruar këtë libër që e mbaj në dorë, sepse, edhe pse i është njeriut para trembëdhjetë shekujsh, ai ka paraparë qartë diçka që mund të bëhej e vërtetë vetëm në këtë shekullin tonë të komplikuar.

Në të gjitha kohët, njerëzit e kanë njohur makutërinë, por kurrë para kësaj makutëria nuk e pat kaluar lakminë e thjeshtë që të arrihej diçka dhe të bëhej obsesion që e megjullon shikimin për çdo gjë tjetër, lakmia joshëse, që të fitohet dhe të punohet, sendërtohet gjithnjë shumë e më shumë – më shumë sot se dje dhe më shumë nesër se sot. Xhindi që kalëron në qafë të njerëzve dhe i kamxhikon zemra e tyre përpara, drejt caqeve, që në mënyrë nxitëse shkëlqejnë në lartësi, por sapo t'i arrijnë treten në hiçgjë të vlefshme për përbuzje, gjithnjë duke ofruar premtim të caqeve të reja përpara – caqeve edhe më të shkëlqyeshme, gjithnjë provokuese derisa janë në horizont, por të përcaktuara të zhduken në hiçgjënë e re, sapo të vijnë për t'i kapur; kurse ajo uri, ajo uri e pangjishme për caqe gjithnjë të reja që e hanë shpirtin njerëzor: "Sikur vetëm këtë të dinit, do të shihnit skëterrën në të cilën jeni..."

Kam parë që kjo nuk ka qenë vetëm urtësia njerëzore e njeriut nga e kaluara e largët në Arabinë e largët. Sado që ai ka mundur të jetë i urtë, njeriu i tillë nuk ka mundur t'i parashohë vetë kokëçarjet aq karakteristike për shekullin e njëzet. Nga Kur'ani ka folur një zë më i madh se zëri i Muhamedit a.s..

Muhamed Asad
"Rruga për në Mekë"

Flakë kashtë

Reflektimi për të shkuarën është tipike për njeriun. Edhe ata që duken si më moskokëçarësit përballen me të në çaste të caktuara të jetës. Është nevojë e brendshme për të kuptuar më mirë veten dhe për të menduar më mirë lëvizjet e rradhës në fushën e shahut të jetës. Çastet më të kthjellta për reflektim janë atëherë kur njeriu përballlet me vështirësi, përballlet me probleme që kërkojnë zgjidhje. Askush nuk dëshiron të ketë vazhdimësi të problemeve, prandaj edhe gjetja e zgjidhjeve është më shumë se e dëshiruar.

Dëshirat janë të pakufizuara dhe burimet të kufizuara na thotë ekonomia. Në rastin tonë zgjidhjet janë të kufizuara, sepse edhe mundësitë e njeriut janë të tilla, sepse edhe vetë njeriu është i tillë. Duke patur mundësi të kufizuara njeriu synon që zgjidhja të jetë më e mira e mundëshme dhe e qëndrueshme në kohë. Mirëpo nuk ndodh gjithmonë kështu, pasi njeriu është qenie e ndërlikuar dhe mund të pësojë ndryshime të papritura në sjellje dhe qëndrime, ndryshime që lidhen me zhvillimin moshor, interesat, motivet. Kjo paqëndrueshmëri e njeriut mbetet sfidë e hapur që ka brenda saj edhe vështirësinë e qëndrueshmërisë, edhe bukurinë e përpjekjeve për të gjetur zgjidhjen optimale.

Dy janë rrugët përmes të cilave reflektimi gjen udhën për tek njeriu. Udhë e parë është pësimi. Shpesh njeriu tregohet dyshues në vlerën e fjalëve dhe këshillave të njerëzve më me përvojë, të njerëzve që janë rrahur me vështirësitë e jetës me dhjetra vite. Mendon se fjala e tyre nuk vlen apo vlen shumë pak për pritshmëritë që ka ndërtuar në mendjen e tij për jetën që e pret. Ndërkohë që i shkon pas me këmbëngulje mendimit individual me shpresën se rruga që kërkon të çajë është më e mira, nuk vëren dheun që i rrëshqet nën këmbë. Fundi i rrugës është gropa e individualizmit të theksuar. Nuk mund të mohohet vlera e shpirtit luftarak, kërkues dhe ëndërrimtar, por një grimë urtësi vlen sa sakrifica e një jete. Nëse shpërfill urtësinë pësimi bëhet i pashmangshëm. Mësimet që

nxjerr, nëse ndodh që të nxjerrësh mësim, janë të vlefshme, por tepër të hidhura. Do të lënë gjurmët më të thella në vetëdijen e njeriut, por të shpresojmë se nuk do të jenë qendërlëkundëse për vlerat dhe parimet.

Udhë e dytë është të nxjerrësh mësim nga historia e atyre që kanë kaluar më herët në këtë botë, dhe nga përvoja e atyre që kanë parë e dëgjuar më shumë në jetë. Kjo nuk do të thotë që të mos ndërmarrësh nisma individuale, por vrullin e energjisë dhe dinamikën shpirtërore t'i ruash dhe mbrosh përmes urtësisë me qëllim që të mos shpenzohen kuturu dhe të humbasin në eter. Njeriu duhet të kujdeset për veten dhe kujdesi më i mirë është të jetë afër njerëzve të urtë e të mençur. Vetëm kështu do të ketë mundësi të vendosë përballë individualizmit një kundërpeshë që do t'i ruajë ekuilibrin e të menduarit.

Natyra e njeriut është plot kundërtënie. Edhe e kërkon urtësinë, zgjidhjen e mençur të situatave të vështira, edhe i pëlqen t'i shkojë nga pas mendimeve të veta fluturake. Nuk është e lehtë të mposhtësh lumin e dëshirave, veçanërisht kur je i ri. Kjo është lufta më e madhe e njeriut, të zgjedhësh mes egoizmit vetjak dhe urtësisë së tjetrit. Në shumë raste njeriu bën sikur e dëgjon urtësinë e tjetrit dhe në fund i bindet vetvetes. Kjo kategori është si flaka e kashtës. Duket sikur do bëjë shumë punë, vjen me vrull të madh dhe pas disa kohësh nuk i njihet as nami e as nishani. Ia kanë edhe vetes me të pabesë, prandaj edhe përfundojnë në këtë farë gjendje. Punët e mira, ku më kryesorja mbetet reflektimi për të nxjerrë vazhdimisht mësim nga pësimet e të tjerëve, që të përmirësosh vetveten në përputhje me parimet e epërme, duan kohën e tyre. Mund të përparojnë ngadalë, por hapat e hedhur janë të sigurtë dhe të qëndrueshëm në kohë. Kjo është pjesa më e rëndësishme, të qëndrueshëm në kohë. Nëse nuk do të jetë i qëndrueshëm në kohë njeriu, nuk mund ta ngrohë flaka e kashtës. Me iluzione nuk mund të përparohet drejt sferave të larta të botës shpirtërore.

Feja dhe Kombësia

E vërteta duhet përsëritur sepse dendur përsëritet edhe gënjeshtria.
Goethe

Po të mos ishte për fjalët shumë të urta të shkrimtarit të madh, Goethe, që kemi vënë këtu sipër, të cilat s'ka njeri t'i mohojë për vërtetësinë e tyre të plotë në jetën praktike, nuk do të ishte mbase e nevojshme që të merreshim sot në këto shtylla me përcaktimin dhe përkufizimin e vërtetë të të dy kuptimeve tashmë të njohura të kryetitullit tonë të këtij shkrimi: "Feja dhe Kombësia". Por, fatkeqësisht, gënjeshtria, në çdo lëmë e në çdo fushë të jetës, përsëritet aq dendur ditë për ditë, e, aty edhe me aq mjeshtëri, saqë e vërteta shpeshherë bie mbas krahëve, errësohet, zhduket dhe zëvendësohet nga gënjeshtria, e cila futet kudo si ndonjë sëmundje e keqe, e në të tilla raste në vend të dritës kemi errësirën, në vend të së mirës të keqen, në vend të lirisë robërinë, në vend të dashurisë urrejtjen, smirën, dhe së fundi, luftën e plotë midis njëri-tjetrit, si njerëz, si komb dhe si shoqëri.

Nuk e di në është fataliteti njerëzor ky apo ndonjë gjë tjetër, që e shtyn njeriun në jetë të gënjejëhet e të gënjejë kaq shumë sa të vërtetat më fillestare të botëkuptimit të tij t'i hedhë mënjanë dhe të kapet mbas paudhësive më të tmerrshme të shpirtit dhe të mendjes, por faktin qëndron kështu, i hidhur si ç'është, që njeriu herë pas here gabohet aq keqas sa të ndërlikojë kuptimin edhe të gjërave më të thjeshta e më të qarta të jetës së tij, dhe ta spekulojë të vërtetën e njëshme aq rëndë sa të bjerë në kataklizmi të llahtarshme.

Pikërisht kjo gjë ka ngjarë dhe me kuptimet "Fe dhe Kombësi", megjithëse këto kuptime e ideale të jetës, si

njëra dhe tjetra, janë aq të vjetra në shpirtin e njeriut sa dhe njeriu vetë. Njeriu, siç na e kanë zbuluar gjithë të diturit, edhe në kohën më primitive të jetës së tij, ka pasur një besim tek një fuqi sipërore dhe një dashuri për kasollen e tij të vogël e të varfër. Tjetër punë nëse ky besim i parë, nga pa-zhvillimi i mjaftueshëm mendor, ka qenë në fillim e për shumë kohë dedikuar një druri a një guri, një mali a një bubullime, dhe dashuria në komb e atdhe ka qenë njësuar me dashurinë e parë fillestare në fëmijët dhe në kasollen e tij, pa u zgjeruar më tej. Historia na provon, pastaj, se paralelisht me zgjerimin dhe përparimin e jetës shoqërore të tij shkoi dhe zgjerimi i botëkuptimit fetar dhe kombëtar të njeriut. Kështu që u arrit me kohë, me kohë shumë të gjatë, të kuptohet nga miliona njerëz besimi i plotë në një Zot dhe dashuria, jo vetëm midis bijve të një kombi, të një race e të një fisi por edhe një harmoni e respekt midis kombeve dhe racave të ndryshme.

Por, fatkeqësisht, megjithëse ky proces i gjatë historik është kryer ka kohë dhe luftërat fetare të njëhershme të bëra nga pa-kuptimi i vërtetë i feve, nga cenet shpirtërore të njeriut, që me zor e kupton të mirën dhe të vërtetën (shumë më lehtë të keqen dhe të rremen), si edhe luftërat për stabilizimin e kombeve dhe të shteteve janë përsëritur sa e sa herë, prapë se prapë njeriu, që si duket kërkon shkaqe grindjeje nga vetë natyra e tij e paqëndrueshme, i nxjerr përsëri në shesh çështjet e vjetruara dhe fillon sërish nga e para të spekulojë mbi to dhe të shkaktojë zënie e grindje të





reja. Dhe dy nga kuptimet njerëzore më të spekuluar e më të përdorura si armë ndasie, midis qindra të tjerash, janë pikërisht feja dhe kombësia, megjithëse kuptimet e këtyre të dyjave janë aq të qarta sa dhe dielli në qiell e s'kanë asnjë pikë kundërshtimi e mosmarrëveshjeje, po të kurorëzohen si duhet, as fetë midis tyre e as me fetë me kombësitë e ndryshme. Megjithëkëtë, të shumtë janë njerëzit që peshkojnë në ujëra të turbullta me anë të feve dhe të kombësive. Të shumtë janë propaganduesit, kudo e më çdo anë, që predikojnë mos-harmoninë midis feve, mos-pajtimin midis kombeve dhe mos-marrëveshjen midis feve dhe kombësive, aty dhe brenda përbrenda një kombi, duke hedhur në vëllavrasje vëllezërit e një mëme, të një gjaku, të kombi e të një atdheu.

Po të ishte se shekulli XX, ku ndodhemi, të kishte qenë me të vërtetë shekullimi i qytetërimit dhe i përparimit të vërtetë shpirtëror, mendor e moral i njeriut, ashtu si ç'ishte shpresuar, spekulimet e mësipërme do të formonin një turp të ziheshin n'goje e jo më dhe të ngjanin aktualisht në jetën tonë. Por shekulli XX s'na doli gjë, dhe bota njerëzore, edhe mbas kaq vjetësh predikimi fetar të kthjellët të kaq profetëve e mbas kaq predikimesh e mësimesh nga dijetarë të shquar, mbeti gati shpirtërisht e errët si ç'ka qenë qindra vjet më parë. Bota e nesërme mbase do të qeshë me ne, që dhe të vërtetat fillestare të jetës nuk i kuptuam dot e na desh herë pas here të kacafytemi si bisha të egra, por realiteti është ky dhe këtij realiteti nuk i shmangemi dot.

Për të vërtetuar që fetë dhe kombësitë në vetvete s'kanë asnjë grindje dhe mosmarrëveshje midis tyre, nuk është nevoja të futemi thellë as në dogmat fetare të asaj ose të kësaj feje e as në parimet kombëtare të atij ose të këtij shteti. Mjafton të themi vetëm se s'ka asnjë fe në botë që të predikojë ndasi e përçarje, vrasje e presje midis njerëzve, mohim gjaku, race e kombi, dhunim e mos-nderim për fenë, besimin, fisin dhe kombin e tjetrit. Jo vetëm kaq, por fetë kanë për parim kryesor mirësinë dhe bujarinë, dashurinë dhe vëllazërimin, respektin dhe nderimin. Dhe kombet po të njëjtat parime ndjekin e respektojnë për të gjithë bijtë e tyre.

Por, atëherë nga del që në praktikën e përditshme të jetës na dalin kaq shumë ndryshime midis njërit e tjetrit? Nga dalin fjalët që kjo fe s'pajtohet me atë tjetrën dhe s'munden të jetojnë bashkë? Kush i nxjerr shtytakat shkatërronjëse që bijtë e një kombi s'mund të jenë vëllezër, po të jenë besnikë fesh të ndryshme?

Përgjigja e këtyre pyetjeve është fjala: "Spekulim". Fetë, idealet, besimet, kombësitë e çdo gjë tjetër e njeriut futen dashur e pa dashur në kthetrat e "spekuluesve", me të cilët fatkeqësisht bota është mbushur plot. Këta "spekulues" janë të lloj-llojshëm: politikanë, ekonomistë, egoistë e sa e sa të tjerë. Këta

kapen për çdo gjëje dhe e kthejnë dhe të bardhën të zezë, dhe të mirën në të keqe, mjafton që t'i arrijnë qëllimit të tyre rrënimtar të paracaktuar.

Ne, shqiptarët, që nën maskën e fesë na janë luajtur kaq herë lodra shumë të rrezikshme për vetë qenien tonë si popull dhe si komb, duhet të jemi tashmë të regjur që të mos biem në duar të errëta dhe të prishim vëllazërimin dhe bashkimin tonë, që janë guri themelor i qenies sonë si komb dhe si shtet i lirë. Një thirrje për këtë qëllim u dha këto ditë me fjalë të hapëta e të singerta e bazë një studimi të thellë filozofik e shoqëror nga një gojëtar, fetar dhe shtetar i shquar i vendit tonë, fjalë që duhen lexuar e rilexuar me vëmendjen më të madhe nga çdo shqiptar.

Si përfundim, nuk bëjmë keq, të japim këtu një sërë të vërtetash themelore, që duhet të kemi gjithmonë parasysh në jetën tonë mbi temën që kemi në bisedim:

- Fetë në vetvete nuk kanë asnjë faj për çdo zihje dhe grindje tonën – fajim ta kërkojmë te vetja jonë, te mungesa e kulturës sonë, te natyra jonë ende e padisiplinuar.

- Fetë duhet t'i njohim themelish e jo përciptazi dhe të vërtetat e tyre morale t'i bëjmë parime praktike të jetës sonë.

- Për fetë që nuk njohim të mos flasim kurrë, se, pikësëpari, kur nuk i njohim s'mund të flasim gjë tjetër veçse marrëzira, që na ulin poshtë nderin dhe prestigjin tonë, dhe, së dyti, fetë tashmë janë të kristalizuara e të mirënjohura dhe avokatia jonë nuk u shton as hije e as dritë.

- Feja s'e çalon kombësinë dhe kombësia s'e ndalon fenë – ajo që i prish të dyja është injoranca, prandaj t'i vihemi kulturimit të mendjes dhe të shpirtit tonë.

- Fetarizma nuk është fanatizma. Mund të jesh fetar por jo fanatik. "Fanatizma e vret fenë për të trembur budallenjtë me hijen e saj", ka thënë një i ditur. Voltaire ka thënë: "Fanatizma me fenë janë si astrologjia me astronominë; bija e marrë e një nëne të mençme".

- Kombëtarizma nuk është ateizma. Mund të jesh mirë kombëtar edhe fetar, e para të lidh me vendlindjen dhe me farefisn tënd, dhe e dyta me Zotin e gjithmbarshëm, që krijoi gjithë rruzullimin, aty brenda dhe ty e Atdheun tënd.

- Ta mbajmë lart dashurinë për kombin e për lirinë, se pa kombësi e liri s'ka as atdhe, s'ka as fe, se rob nuk është i lirë që t'i falet as Zotit.

- Të mbajmë lart bashkimin dhe vëllazërimin dhe t'i tregojmë rrugën kujtdo që mundohet të na ndajë e të na përçajë.

Me këto parime e mendime le të ecim si kurdoherë të lidhur e të bashkuar që të gjithë drejt Zotit e Kombit, dhe me këtë besim le të punojmë pa pushim për të mirën e të mbarën e Atdheut tonë të dashur.

Beqir Haçi

Botuar në revistën "Njeriu", nr. 11 (23), maj 1944.



HAFIZ

QAZIM ZENEL RAKIQI

(1921-1991)

Hafiz Qazimi ka lindur në vitin 1921 në lagjen Zdralej të qytetit të Shkodrës në një familje të ndershme tregtari të vogël. Të tre djemtë, Qazimin, Shfikun dhe Xhevdetin, i ati pati dëshirë t'i arsimojë, e nëse më dy të tjerët ia arriti më lehtësisht, Qazimi pati tjetër fat në jetë. Pas një sëmundjeje në moshën dy vjeçare ai humbet shikimin. Për të, prindërit e pjestarët e tjerë të familjes kjo qe një goditje e rëndë. Por atë cka humbi përgjithmonë, të pamët e kësaj bote, Zoti i Madhnueshëm xh.sh. ia kompensoi me një dhunti tjetër, kujtesën, që ai e pati krejt të veçantë nga të bashkëmoshatarëtve. Plus kësaj, edhe vullneti e bëri atë të mos tërhiqej nga jeta.

I shoqëruar nga pjestarët e familjes, ai çdo ditë pas moshës 7-vjeçare shkon në mejtepin e Xhamisë Plakë, ku ishte imam dhe mësues besimi Hafiz Ibrahim Dibra. Me një kujdes e durim të theksuar, ai i mëson Qazimit lëndët fetare e Kur'anit e Madhnueshëm përmendësh, aq sa thonë se në komisionin provues ai i ka entusiazmuar të gjithë e ku ka fituar edhe titullin "Hafiz".

Hafiz Qazimi pat një zë të ëmbël, të shtruar e tërheqës. Besimtarët e lagjes e ruajnë në kujtesë fort mirë kur ai këndonte Ezanin në minaren e Xhamisë Plakë, i lejuar me shumë kënaqësi nga Hafiz Ibrahim.

Me propozimin e Myftinisë së Shkodrës, Këshilli i Përgjithshëm i Komunitetit Mysliman Shqiptar, e emëron myezin në Xhaminë Plakë, pranë shtëpisë së tij. Në këtë institucion fetar ai shërbeu për 20 vjet, në harkun kohor 1947-67.

Si myezin i kishte shokët e rrallë. I shoqëruar në të pesë vaktet në xhami nga i ati, e ëma, vëllezërit, e shoqja e bija, Hafiz Qazimi kryente me përkushtim detyrën që i ishte besuar, duke fituar respektin e veçantë të besimtarëve.

Edhe pse i verbër plotësisht, Hafiz Qazimi nuk u kufizua vetëm në xhaminë e tij, atë do ta shihje edhe në

xhami të tjera të qytetit në raste festash e rritesh fetare, ku shkonte edhe për të plotësuar kulturën e tij fetare. Atë që i mungonte nga të lexuarit e librave fetarë, ai e gjente në ilahitë, vasat e ligjëratat që jepnin kolegët e tij hoxhallarë, veçanërisht në Xhaminë e Parrucës. Me këtë vullnet të pashoq, ai i bëri vend vetes, për ta respektuar jo për "mëshirë", por për aftësinë që shpaloste. Si të tillë i lëshuan radhë, se e meritonte, që të bënte në jo pak raste komentin e Kur'anit të Madhnueshëm dhe të merrte pjesë në këndimin e Mevludeve me atë zë të bukur, si në xhamitë e qytetit ashtu dhe të fshatrave të Shkodrës.

Pas vitit 1967, si të gjithë hoxhallarët e tjerë, edhe hafiz Qazimi e ndërpreu aktivitetin legal fetar, për ta ushtruar atë në shtëpi pa ndërprerje.

E përjetoi thellë lejimin e besimeve fetare mbas vitit 1990. Edhe pse i lodhur nga jeta, u ngrit të shkonte e të merrte pjesë në mitingun madhështor të organizuar në Xhaminë e Plumbit më 16. 11. 1990, madje e nderuan duke e ngjitur në tribunë dhe duke i lënë radhë të këndonte përmendësh Kur'anin e Madhnueshëm, duke entusiazmuar pa masë pjesëmarrësit dhe veçanërisht të rinjtë që nuk e njihnin.

Kjo ngjarje, siç thonë familjarët, sikur i solli dritën e syve. E ftonin dhe nuk e këndonte Kur'anin. Kur u bë përurimi i Xhamisë së Kirasit, tregon vajza e tij, besimtarët erdhën, e morën dhe e sollën me makinë, e po kështu nderime i bënë edhe hoxhallarët e tjerë, siç qe Haxhi Hafiz Vehbi Gavoçi, me të cilin qenë njohur që në fëmëni, etj.

Hafiz Sabri Koçi, e ka çmuar shumë Hafiz Qazimin, që si pak kush e lidhi tërë jetën e tij me Allahun Xh, Sh. Dhe fenë e madhnueshme Islame.

Ai vdiq më 06.10.1991.

TË NDËRTOSH *familje*



Familje quhet struktura e përbërë nga nëna, babai dhe fëmijët dhe konsiderohet si pjesa më e vogël e shoqërisë.

Njeriu është një krijesë e nderuar dhe e veçantë. Ekzistenca, zhvillimi i shëndetshëm i karakterit të tij lidhet ngushtë me familjen. Parë nga ky këndvështrim familja është si një shkollë ku nëna dhe babai janë mësuesit e parë. Ambjenti familjar është ambjenti më i përshtatshëm për zbulimin e perceptimeve materiale dhe shpirtërore.

Familja mund të quhet institucioni i parë i cili u jep formë të ardhmes së shoqërive. Shenjtëria e familjes kurorëzohet me nikahun (celebrimin).

Martesa është hapi i parë i krijimit të familjes. Në çdo martesë duhet të ekzistojë një qëllim, një objektiv i caktuar që duhet të tejkalojë plotësimin e nevojave fizike të njeriut. Gjatë arritjes së këtij objekti të fisëm çiftit i dhurohen mirësi e begati të panumërta.

Së dyti dashuria, respekti dhe besnikëria janë shkallët më të rëndësishme drejt rrugës së një martese të lumtur.

Cilët janë faktorët primarë?

Në këtë listë ne rresht të parë duhet të zërrë vend siguria, besueshmëria. Martesat e mbështetura në besim janë më të shëndetshme. Më pas mund të rradhisim dashurinë dhe respektin. Dashuria mund të përfshijë uljet e ngritjet e saj por respekti duhet të jetë vazhdimisht i konsoliduar dhe i gjallë.

Një tjetër çështje që duhet patur parasysh është logjika dhe gjykimi. Ndjenjat janë shumë të rëndësishme por nuk mund të veprojnë të veçuara nga njëra tjetra sepse mund të gabojnë. Në raste të tilla është e rëndësishme të këshillohesh me dike dhe të vlerësosh ekuilibrin martesor. Përshtatshmëria në mendime e ndjenja, paralelizimi në prishmëritë martesore dhe idealet në lidhje me rritjen e edukimin e fëmijëve janë faktorë shumë të rëndësishëm në një martesë të shëndetshme. Martesat e konceptuara sipas këtij këndvështrimi janë të suksesshme dhe krijojnë një familje të shëndetshme.

Çfarë duhet patur parasysh për ruajtjen e harmonisë dhe lumturisë familjare?

Në familjet e lumtura parësore është dhembshuria dhe mëshira. Individët e familjes kanë zhvilluar aftësi empatike ndaj njëri tjetrit, kanë një komunikim të mirë dhe asnjëherë nuk përdorin gjuhën e kritikës. Në familje të tilla mbizotëron termi ne, organizohen aktivitete të përbashkëta, ndarja dhe solidariteti janë themelore. Të gjithë duan njëri tjetrin, vlerësojnë mendimet e ndjenjat përkatëse. Gënjeshtra, shtrirja, hipokrizia as nuk ndalen ndonjëherë në familje të tilla. Nuk ekziston as hatërmbetja, urrejtja etj. Të falësh konsiderohet një virtyt i lartë. Fjalët dalin nga shpirti dhe gjejnë pasqyrimin e tyre në zemrat e anëtarëve. Kjo strukturë nuk harxhohet për interesa të kësaj bote e cila vlerësohet thjesht si një vend kalimtar.

Familje të tilla bazohen në principin 'të shkatërrosh familjen është shumë e thjeshtë por ta ndërtosh dhe ruash atë është shumë e vështirë' dhe përpiqen të nxjerrin anëtarë të denjë për shoqërinë ku jetojnë.

Në këtë mënyrë familja shndërrohet në një fole të lumtur mbushur me aromën e parajsës dhe si një koridor i cili të shpie në kopshtet e parajsës ku fshihen fëmijë të pafajshëm e të lumtur.

Nënat dhe baballarët që luajnë me fëmijët e tyre, e vënë veten në vendin e fëmijëve janë projektuesit e së ardhmes të fëmijëve dhe përmbushin misionin e vërtetë të familjes.

Në këtë fole secili flet me gjuhën e dashurisë sepse zemrat hapen më lehtë me këtë gjuhë. Familja është një fole edukimi.

Familja nuk është një bashkim anëtarësh vetëm në këtë botë por planifikohet dhe shpresohet të jetë e tillë edhe në botën tjetër.

Kalaja më e fortë e një shoqërie është familja. Me shpresën e ndërtimit të kalave të forta dhe të mbrojtjes së tyre deri në ditën e fundit....

Kanceri

NJË ANARKI QELIZORE

Kanceri në ditët e sotme konsiderohet një sëmundje komplekse e cila merr miliona jetë çdo vit në mbarë botën. Megjithatë ekzistojnë lloje të ndryshëm kanceri, të gjithë kanë një veçori të përbashkët, anarkinë qelizore. Nëse bëjmë një krahasim midis anarkisë shoqërore, e cila është mungesë e ligjit në shoqëri, çrregullsi politike në drejtim dhe ide shkatërrimtare, kanceri nga ana tjetër është diçka e ngjashme në nivel qelizor.

Në rast anarkie, shteti mund të dërgojë ushtrinë në një zonë të caktuar për të vendosur qetësinë dhe të

marrë situatën nën kontroll. Në mënyrë të ngjashme, përgjigja e parë e organizmit ndaj një rritje qelizore anarkike është aktivizimi i mekanizmave që i çojnë ato në vetëshkatërrim (apoptosis). Sipas mendimit të shekullit të 20-të Said Nursi, anarkia nuk njeh norma, as ligjet e shoqërisë së organizuar duke shkatërruar rregullin dhe duke lënë çdo gjë në dorë të rebelimit. Për më tepër, anarkia nuk merr parasysh të drejtat e askujt. Kanceri nga ana tjetër, thyen ligjet gjenetike që organizojnë rritjen qelizore dhe shkatërron rrugët që

frenojnë formimin tumoral. Kështu, ai eliminon ligjin dhe rregullin duke promovuar kaos, malinjitet dhe duke mos njohur të drejtat e qelizave të tjera të organizmit vetëm për hir të rritjes së vet.

Trajtimi i kancerit

Ditët e sotme kanceri kurohet kryesisht me kimioterapi, radioterapi, kirurgji dhe deri diku me imunoterapi. Disa nga qëllimet e kimioterapisë përfshijnë rritjen e jetëgjatësisë, pakësimin e vuajtjes së pacientit dhe mundësisht kurimin e plotë të tij. Fatkeqësisht, së bashku me vrasjen e qelizave tumorale, kimioterapia vret edhe qelizat normale të organizmit të cilat bëjnë ndarje të shpeshta. Një tjetër disavantazh është se kjo terapi nuk është specifike për një lloj të caktuar kanceri dhe efikasiteti i saj varet nga një pacient tek tjetri, kështu që lind nevoja të shoqërohet me radioterapi.

Radioterapia, siç duket nga emri, përdor një tufë rrezatimi të jonizuar për të vrarë qelizat kanceroze. Ajo shkatërron AND-në qelizore dhe më pas qeliza shkatërrohet sepse programi i saj për një ndarje të re është ndërprerë. Radioterapia është më e përdorshme për kancere të lokalizuar në njërën pjesë të trupit dhe gjithashtu përdoret si ndihmesë pas kirurgjisë për të parandaluar rishfaqjen e kancerit pas heqjes së tij. Sidoqoftë, edhe radioterapia ka efektet e saj anësore dhe ajo vetë mban riskun e nxitjes së një kanceri të ri.

Qelizat e organizmit duhen trajtuar me drejtësi

Kimioterapia dhe radioterapia dëmtojnë si qelizat kanceroze ashtu edhe ato të shëndetshme duke u treguar të padrejta me këto të fundit. Drejtësia absolute kërkon mbrojtje të qelizave normale ndërkohë që luftohen qelizat kanceroze. Nga ana tjetër, drejtësia relative për hir të shëndetit të të gjithë organizmit sakrifikon disa nga qelizat e tij të shëndetshme. Duhet të pranojmë se drejtësia absolute është gjithmonë alternativa më e mirë nëse mund të aplikohet ashtu siç duhet. Sidoqoftë, drejtësia relative mund të quhet e justifikuar në rast se drejtësia absolute nuk mund të praktikohet. Sot po bëhen përpjekje të mëdha që kimioterapia dhe radioterapia të kenë sa më pak efekte anësore të cilat vijnë si pasojë e dëmtimit të qelizave normale të organizmit. Kërkimet janë në drejtimin e drejtësisë absolute ku trajtimi të fokusohet vetëm mbi qelizat kanceroze.

Qelizat T kundër kancerit të pajisura me receptorë antigjenik kimerik

Ekzistojnë 3 përqasje në imunoterapinë kundër kancerit që janë, imunizimi, përdorimi i antitropave dhe imunoterapia qelizore. Imunizimi ose vaksinimi përdor një vaksinë kundër kancerit duke përgatitur qelizat imunitare të organizmit të njohin qelizat kanceroze dhe t'i luftojnë ato. Terapia me antitropa specifike kundër kancerit

rekruton qelizat imunitare drejt qelizave kanceroze të mbuluara me antitropa për t'i shkatërruar. Imunoterapia qelizore, nga ana tjetër, përdor qelizat imunitare të vetë organizmit si p.sh. limfocitet Natyral Killer, limfocitet T citotoksike etj, kundër qelizave kanceroze.

Qelizat T citotoksike janë qeliza imunitare specifike të cilat njohin qeliza shenjë përmes receptorëve specifike. Dekadat e fundit, shkencëtarët kanë prodhuar receptorë të qelizave T dhe receptorë kimerik të cilët në mënyrë specifike njohin qeliza shenjë. Qeliza kanceroze mbulohet nga këto antitropa dhe njihet nga qelizat citotoksike ose aktivizon mekanizma vetëvrasës (apoptozë). Këto metoda janë përdorur me sukses në trajtimin e limfomës, kancerin kolorektal dhe melanomës.

Anarkia, spiritualiteti dhe terapia e lutjes

Uria, varfëria, pabarazia sociale dhe problemet ekonomike mund të përcaktohen si baza e anarkisë në një shoqëri njerëzore. Megjithatë, sipas Nursiut, baza e vërtetë e anarkisë është dobësia dhe varfëria shpirtërore. Në mënyrë të ngjashme, baza për sëmundjet kanceroze mund të jetë mungesa e një jete shpirtërore të pasur e cila për pasojë e bën njeriun të bjerë shpirtërisht dhe të dobësohet fizikisht. Për shembull, agjërimi si një adhurim i detyruar i feve monoteiste është një praktikë shpirtërore dhe fizike e cila ka dhënë prova se është efektive në trajtimin e kancerit. Nga studimet e sakta është vënë re se pacientët me besim të fortë fetar dhe me lutje dhe adhurim të vazhdueshëm kanë një gjendje shpirtërore më të mirë dhe mund t'i kalojnë sëmundjet më shpejt se të tjerët pa besim. Atëherë lind pyetja: a lind kanceri gjithashtu nga veprimi i qenieve shpirtërore të këqija të cilët manipulojnë sistemin e AND-së qelizore duke shkaktuar anarki? A janë këto krijesa që përmenden në Kur'anin Famëlartë të krijuara nga zjarri pa tym (Kur'an, 15:27) një lloj rrezatimi jonizues që i jep mundësi kancerit të zhvillohet? Nëse është kështu, a nuk duhet të kërkojmë të kurohemi si me mënyrat e mjekësisë tradicionale ashtu edhe me ato shpirtërore?

Disa shkaqe të vërtetuara shkencërisht si shkaktare të kancerit përfshijnë duhanpirjen, infeksionet virale, rrezatimin dhe ndotjen urbane të cilat çojnë në defekte gjenetike të AND-së qelizore. Duke marrë në konsideratë faktin se shumë pacientë janë shëruar nga sëmundjet kanceroze duke recituar lutje, atëherë raste të tilla ia vlen të ekzaminohen dhe të gjejmë se deri në cilën pikë faktorët jomaterialë janë të përfshirë si shkaktarë sëmundjesh. Studimi i këtyre rasteve mund t'i japë shkencës moderne mundësi të reja për të kapërcyer pengesat dhe për të bërë hapa gjigantë përpara në fushën e mjekësisë e duke kombinuar terapinë medikamentoze me ato të lutjeve shpirtërore për të mirën e pacientit në nevojë.

Përktheu: Erion Sukaj

I gjalli dhe i vdekuri

Disa njerëz pranë një lëndine,
Për një problem rrahën mendime;
Cili është njeri i gjallë,
Cili është njeri i vdekur, vallë?"
Kush qëllon n'thundër, tjetri n'patkua,
E drejta n'fund është përshkruar.
Si n'çdo tubim kur debatojmë,
Mendimet poshtë po i grupojmë.
-I gjalli është i formësuar komplet,
I vdekuri ka vetëm skelet.
-I gjalli ecën, merr frymë, jeton,
Ai që vdes, krejtësisht ndryshon.
-I gjallë është ai që kudo ndeshet,
I vdekuri jo, se në varr tretet.
-Kush ka para, ka gjë e mall,
Çka nuk i ka aq që s'është i gjallë.
Pati mendime edhe të tjera,
Si vrimat n'ujë tretur nga era.
-Në fund u shfaq ajo që zhytet,
Gjer n'fund të detit, por kurrë nuk mbytet:
Janë në këtë jetë gjallë ata njerëz,
Që n'një Zot mbështeten për çdo ditë shpesh.
Gjallë janë ata, ndonëse janë t'vdekur.
Në rrugë të Zotit gjithmonë kanë ecur.
I vdekur është ai që sot merr frymë.
Ta përmendë Zotin veten s'e shtyn.
Këtu hyjnë speciet që në këtë botë,
Vështirë u shihet dhe hija n'tokë.





BOTIMET KMSH

**NË PANAIRIN E LIBRIT
16-20 NËNTOR 2022**

**Të gjitha botimet e Komunitetit
Mysliman të Shqipërisë i gjeni
në Panairin e Librit nga data 16
deri më 20 nëntor 2022.**

**Në stendën e KMSH-së gjeni edhe botimet e
Bashkësisë Islame të Kosovës dhe Bashkësisë
Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë së Veriut.**



www.kmsh.al

